



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 68 Akti

Nr. 82 Vendimi
Tiranë, më 26.11.2018

V E N D I M

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, me anë të trupit gjykues të përbërë nga:

Roland Ilia	Kryesues
Firdes Shuli	Anëtare
Etleda Çiftja	Relatore

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Olsida Goxhaj, në prezencë edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, znj. Mia Roessingh, më datë 22 nëntor 2018, ora 12:00, në Pallatin e Koncerteve, kati i I-rë, zhvilloi seancën dëgjimore mbi çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Artur Selmani, prokuror pranë Prokurorisë së Përgjithshme.**

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe neni Ç, D, DH, E dhe Ë të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;**
Ligji nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;
Ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;
Ligji nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, znj. Etleda Çiftja, mori në shqyrtim dhe analizoi provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit kryesisht, dëgjoi subjektin e rivlerësimit, z. Artur Selmani, vëzhguesin ndërkombëtar, znj. Mia Roessingh, pasi shqyrtoi në tërësinë e saj çështjen që i përket subjektit të rivlerësimit, z. Artur Selmani, i cili në seancë dëgjimore publike kërkoi konfirmimin e tij në detyrë, si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I.

1. Z. Artur Selmani, është subjekt i rivlerësimit për shkak të funksionit të tij si prokuror pranë Prokurorisë së Përgjithshme. Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë të ligjit nr. 76/2016, datë 22.07.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar” dhe ligji nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (këtu e më poshtë referuar si “ligji nr. 84/2016”), specifikon se: *“Të gjithë gjyqtarët, duke përfshirë gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë; të gjithë prokurorët, duke përfshirë Prokurorin e Përgjithshëm, Kryeinspektorin dhe inspektorët e tjerë pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë, i nënshtrohen rivlerësimit ex officio”.*

2. Në bazë të pikës 4 të neni 4 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, z. Artur Selmani i është nënshtuar procesit të rivlerësimit, duke u shortuar, më datë 15 janar 2018, me trupin gjykues nr. 4, të përbërë nga:

Roland Ilia	Komisioner
Firdes Shuli	Komisionere
Etleda Çiftja	Relatore

3. Menjëherë pas hedhjes së shortit, u administruan raportet e vlerësimit të hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (këtu e më poshtë referuar si “**ILDKPKI**”), sipas neneve 31 - 33 të ligjit nr. 84/2016; Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (këtu e më poshtë referuar si “**DSIK**”), sipas neneve 34 - 39 të ligjit nr. 84/2016; dhe Inspektorati pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë (këtu e më poshtë referuar si “**IKLD**”), sipas neneve 40 - 44 të ligjit nr. 84/2016.

4. Trupi gjykues nr. 4, i shortuar më datë 15.01.2018, pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (këtu e më poshtë referuar si “**Komisioni**”), me vendimin nr. 1, datë 24.01.2018, pas studimit të raporteve të sipërpërmendura të vlerësimit, të hartuara nga institucionet shtetërore, vendosi të fillojë hetimin administrativ të thellë dhe të gjithanshëm sipas neni 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit; të caktojë kryesues të trupit, z. Roland Ilia; të gjithë anëtarët deklaruan mosqenien në kushtet e konfliktit të interesit.

5. Më datë 06.11.2018, trupi gjykues, me anë të vendimit nr. 2 vendosi: (i) të përfundojë hetimin paraprak për subjektin e rivlerësimit, z. Artur Selmani, bazuar në relatimin mbi rezultatet e hetimit të paraqitur nga relatori i çështjes; (ii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit se i ka kaluar barra e provës mbi rezultatet e hetimit, në bazë të paragrafit 5 të neni D të Aneksit

të Kushtetutës në lidhje me nenin 52 të ligjit nr. 84/2016; (iii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit për t'u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016, neneve 45 - 47 dhe 35 - 40 të Kodit të Procedurave Administrative; (iv) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi të drejtat që gëzon nga ligji në lidhje me deklarin e konfliktit të interesit, të drejtën për të kërkuar marrjen e provave të tjera ose thirrjen e dëshmitarit, si edhe afatin brenda të cilit mund t'i ushtrojë këto të drejta.

6. Më datë 06.11.2018, me anë të postës elektronike, trupi gjykues njoftoi subjektin e rivlerësimit mbi: (i) rezultatet e hetimit kryesisht; (ii) kalimin e barrës së provës sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe që të sjellë prova për të provuar të kundërtën, nëse disponon, brenda 15 ditëve nga marrja e njoftimit me *e-mail*; (iii) njohjen me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016, neneve 45 - 47 dhe 35 - 40 të Kodit të Procedurave Administrative, duke paraqitur kërkesë për njohje me dosjen brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit me *e-mail*; (iv) përbërjen e trupës gjykuese.

7. Në datë 08.11.2018, subjekti i rivlerësimit kërkoi shtyrjen e afatit të paraqitjes së parashtrimeve përfundimtare, duke qenë se nuk i ishte bërë e mundur aksesi në dokumentacion ditën që subjekti kishte ardhur për të askesuar dokumentacionin. Komisioni i dha dhe 1 ditë shtesë subjektit të rivlerësimit për të paraqitur shpjegimet e tij në lidhje me rezultatet e hetimit kryesisht.

8. Më datë 19.11.2018, subjekti i rivlerësimit, dërgoi pranë Komisionit shpjegimet e tij së bashku me provat, në protokollin e institucionit.

9. Më datë 19.11.2018, me anë të vendimit nr. 3, trupi gjykues vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit, z. Artur Selmani, në seancë dëgjimore në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016 dhe, me anë të postës elektronike subjekti i rivlerësimit u njoftua se seanca dëgjimore do të zhvillohej, më datë 22.11.2018, ora 12:00, në Pallatin e Koncerteve, kati i I-rë , Tiranë.

10. Më datë 22.11.2018, ora 12:00, u zhvillua seanca dëgjimore në prezencë të subjektit të rivlerësimit.

11. Bazuar në pikën 1 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vendosi të përfundojë procesin e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, z. Artur Selmani, bazuar në të tre kriteret e rivlerësimit, vlerësimin e pasurisë, kontrolli i figurës dhe vlerësimi i aftësive profesionale

II. SEANCA DËGJIMORE

Më datë 22.11.2018, u zhvillua seanca dëgjimore, në prezencë të subjektit të rivlerësimit, në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016 dhe në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, Znj. Mia Roessingh.

Në seancë subjekti i rivlerësimit u paraqit vetë personalisht. Ai parashtrroi shpjegimet e tij në seancë.

Seanca dëgjimore e datës 22.11.2018 u ndërpre, për të rifilluar më datë 26.11.2018, për shpalljen e vendimit.

Në përfundim të seancës dëgjimore, subjekti i rivlerësimit kërkoi konfirmimin në detyrë.

III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

Subjekti i rivlerësimit, z. Artur Selmani, ka qenë bashkëpunues në procesin e rivlerësimit të tij, duke u përgjigjur kur është kërkuar, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI ADMINISTRATIV I KRYER NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Procesi i rivlerësimit që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b dhe Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë. Sipas kreut IV, V dhe VI të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”:

- i. ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të paraqitur një raport me konstatime në lidhje me vlerësimin pasuror;
- ii. DSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë kontrollin e figurës së subjekti të rivlerësimit duke paraqitur pranë Komisionit një raport me konstatimin në lidhje me përshtatshmërinë apo papërshtatshmërinë e subjekti të rivlerësimit, dhe
- iii. Prokuroria e Përgjithshme është organi përkatës i vlerësimit profesional i cili në përfundim të shqyrtimit të dokumenteve ligjorë të përzgjedhura nga vetë subjekti i rivlerësimit si dhe 5 dokumenteve të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, përgatit një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar.

Megjithëse sa më lart, referuar vendimit nr. 2/2017¹ të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

V. RIVLERËSIMI I PASURISË

V/1. Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja

Me shkresën nr. ***, datë 13.11.2017, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar, pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, z. Artur Selmani, i cili është bërë subjekt

¹ Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i pabazuar. Sipas nenit 179/b, pika 5, të Kushtetutës, rivlerësimi kryhet nga Komisioni, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit nr. 84/2016: “Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit”. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryhen vetë Komisioni gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit nr. 84/2016, parashikohet se “Procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Apelit, Komisionerët Publikë, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë”. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezultojnë se: “Në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse.”

deklarues pranë ILDKPKI-së në vitin 2003, me numër indeksi *** dhe në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 9367, datë 10.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar.

Subjekti i rivlerësimit ka dorëzuar deklaratat e interesave private nga viti 2003 deri në vitin 2016 dhe, referuar ligjit nr. 84/2016, ka dorëzuar, më datë 30.01.2017, “Deklaratën e Pasurisë së Rivlerësimit Kalimtar, Vetting”. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera nga ILDKPKI-ja për secilën pasuri dhe të ardhur të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit dhe personave të lidhur, është konstatuar:

- a. deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;
- b. ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
- c. nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
- d. nuk ka kryer deklarim të rremë;
- e. subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

V/2. Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni

Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, hetoi dhe vlerësoi të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga vetë subjekti pranë ILDKPKI-së në “Deklaratën e Pasurisë për Rivlerësimin Kalimtar, Vetting” të vitit 2017; (b) raportin e dorëzuar pranë Komisionit nga ILDKPKI-ja; (c) deklaratat vjetore të deklarimit të pasurisë pranë ILDKPKI-së nga viti 2003 deri 2016 (d) provat shkresore/dokumentet të administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (e) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit me anë të komunikimit elektronik; (ç) shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit, datë 19.11.2018, e në vijim, deri ditën e seancës dëgjimore për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

Komisioni hetoi në mënyrë të pavarur çdo informacion dhe konkluzion të ILDKPKI-së, ashtu sikurse të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me ligjin nr. 84/2016, hetim i cili konsistoi në (i) verifikimin e vërtetësisë së deklaratimeve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe personave të lidhur; (ii) në verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe shpenzimeve, me qëllim evidentimin e mungesës së mundshme të burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë; (iii) në evidentimin e ndonjë fshehjeje të mundshme të sendeve në pronësi ose përdorim; dhe (iv) në evidentimin e ekzistencës së mundshme të deklaratimeve të rreme apo të ndonjë konflikti të interesave, të parashikuar nga neni 33, pika 5, e ligjit nr. 84/2016.

V/3. Në lidhje me pasuritë dhe likuiditetet e deklaruar në “Deklaratën e Pasurisë për Rivlerësimin Kalimtar, Vetting” të vitit 2017, nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur:

Deklarimet e subjektit të rivlerësimit

1. Apartament banimi, me sipërfaqe 119 m², vendndodhja, Rr. “****”, Tiranë, përfitur me kontratën e shitblerjes me nr. ***, datë 02.09.1999. Çmimi i këtij apartamenti është likuiduar me anë të kredisë së marrë nga Banka e Kursimeve sipas VKM-së, nr. 102, datë 05.03.1999, ”Për trajtimin me strehim të funksionarëve të administratës së lartë shtetërore”. Çmimi i blerjes 4.000.000 lekë. Në bashkëpronësi 50 % me bashkëshorten.

Burimi i krijimit:

- ✓ Kontratë huaje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 07.10.1999, me palë huadhënëse, Banka e Kursimeve, me afat 25 vjet.
- ✓ Dokument nr. *** prot., datë 15.07.1999, për dhënie kredie për strehim nga Këshilli i Ministrave.
- ✓ Urdhër nr. ***, datë 16.04.2004, “Për ngritjen dhe funksionimin e Grupit të Punës me ekspertë për Reformën në Drejtësi”.

Komisioni, për vërtetimin e faktit dhe burimit të të ardhurave, administroi nga institucionet:

- 1.1. Deklarata “Vetting” e dorëzuar pranë ILDKPKI-së, më datë 30.01.2017.
- 1.2. Deklarata e interesave private, për herë të parë në vitin 2003.
- 1.3. Kontratë huaje, nr. *** rep., nr. *** kol., datë 07.10.1999, me palë huadhënëse, Banka e Kursimeve, me afat 25 vjet.
- 1.4. Kontratë shitje, nr. *** rep., nr. *** kol., datë 02.09.1999.
- 1.5. Dokument nr. *** prot., datë 15.07.1999, për dhënie kredie për strehim nga Këshilli i Ministrave.
- 1.6. Urdhër nr. ***, datë 16.04.2004, “Për ngritjen dhe funksionimin e Grupit të Punës me ekspertë për Reformën në Drejtësi”.
- 1.7. Shkresën nr. *** prot., datë 18.10.2018, “Kthim përgjigje”, nga “Raiffeisen Bank”.
- 1.8. Shkresa me nr. *** prot., datë 12.02.2018, ardhur nga ZVRPP-ja Tiranë, nga ku konfirmohet se në emër të z. Artur S. Selmani figuron pasuria e paluajtshme në ZK ***, me sipërfaqe 119 m², pasuria e deklaruar nga subjekti në deklaratën e pasurisë.

a. Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me ligjin e zbatueshëm.

- 1.9. Në deklaratën “Vetting” të vitit 2017, subjekti i rivlerësimit deklaroi se ka në pronësi një apartament banimi, me sipërfaqe 119 m², ndodhur në, Rr. “****”, pallati ***, apartamenti ***, Tiranë. Përfitur me anë të kontratës së shitjes, nr. *** rep., nr. *** kol., datë 02.09.1999.
- 1.10. Po në deklaratën “Vetting”, subjekti deklaroi si burim krijimi të blerjes së këtij apartamenti: (i) kontratën e huas, nr. *** rep., nr. *** kol., datë 07.10.1999, me palë huadhënëse, Banka e Kursimeve, me afat 25 vjet. (ii) dokumentin nr. *** prot., datë 15.07.1999, për dhënie kredie për strehim nga Këshilli i Ministrave (iii) urdhrin nr. ***, datë 16.04.2004, “Për ngritjen dhe funksionimin e Grupit të Punës me ekspertë për Reformën në Drejtësi”.
- 1.11. Nga hetimi kryesisht i Komisionit, u konstatua se në lidhje me sipërfaqen e këtij apartamenti kishte mospërputhje deklarimesh, për shkak se në deklaratën “Vetting”, sipërfaqja deklarohet 119 m², ndërsa në deklaratën vjetore të vitit 2003 (formulari A-1), deklarohet se sipërfaqja e banesës është 130 m².
- 1.12. Nuk provohet me dokument justifikues ligjor kalimi i shumës prej 4.000.000 lekësh, që kishte shërbyer për blerjen e këtij apartamenti nga “Raiffeisen Bank” ose kalimi i kësaj

shume në favor të palës shitëse, shtetasve A.D. dhe B.Q., sipas kontratës së shitjes, nr. *** rep., nr. *** kol., datë 02.09.1999, për blerje banese.

1.13. Në dokumentacionin e dorëzuar pranë ILDKPKI-së për këtë apartament, u konstatua se mungon dokumentacioni provues ligjor për kalimin e transaksionit të pagesës së shumës së blerjes, prej 4.000.000 lekësh.

1.14. Komisioni me anë të pyetjeve të dërguara në tetor 2018, me anë të postës elektronike, i kërkoi subjektit të rivlerësimit të paraqiste dokumentacionin provues për pagesat e kryera nga ana subjektit të rivlerësimit për blerjen e këtij apartamenti.

1.15. Nga ana e subjektit u paraqit shkresa me nr. *** prot., datë 18.10.2018, "Kthim përgjigje", nga "Raiffeisen Bank", ku citohej se: "*Ju sqarohet se bazuar në kushtet e kontratës ish-Banka e Kursimeve ka lëvruar shumën e huas prej 4.000.000 lekësh në favorin tuaj(subjektit). Nga ana jonë janë verifikuar dokumentet që ndodhen në dosjen tuaj të kredisë por nuk rezultojn të jetë administruar ndonjë dokument që vërteton kalimin e kësaj shume në favor të palës shitëse. Gjithashtu ju sqarohet se sipas rregullave të ish-Bankës së Kursimeve si dhe rregullave aktuale të "Raiffeisen Bank" afati i ruajtjes së dokumenteve kontabël është 10 vjet*".

1.16. Apartamenti është likuiduar me anë të kredisë së marrë nga Banka e Kursimeve, datë 07.10.1999, kësti mujor në shumën prej 19.000 lekësh. Shuma e mbetur në fillim të vitit 2003 është 4.914.808 lekë, sipas VKM-së, nr. 102, datë 05.03.1999, "Për trajtimin me strehim të funksionarëve të administratës së lartë shtetërore". Kontratë huaje, nr. *** rep., nr. *** kol., datë 07.10.1999, me palë huadhënës, Banka e Kursimeve, me afat 25 vjet, në shumën 4.000.000 lekë. Shuma e detyrimit të mbetur në fillim të vitit 2003 është 4.914. 808 lekë.

1.17. Nga analiza financiare e vitit 2003, Komisioni konstatoi se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare në shumën prej 65.541 lekësh.

1.18. **Subjekti i rivlerësimit, me anë të shpjegimeve dhe provave dërguar, pranë Komisionit, më datë 19.11.2018, si dhe deklaratimet në seancën dëgjimore, shpjegoi se:**

1.19. **Në lidhje me mospërputhjen e sipërfaqes së banesës**, subjekti i rivlerësimit shpjegon se kjo mospërputhje ka ndodhur pasi për sipërfaqen e banesës që subjekti ka deklaruar i është referuar sipërfaqes që shfaqej në kontratën e shitblerjes së banesës, në të cilën është shënuar 136 m², dhe se sipërfaqen prej 130 m² e kishte deklaruar gabimisht në vend të sipërfaqes 136 m².

1.20. Më pas, ai shpjegon se kur është pajisur me aktin e certifikatës së pronësisë nga ZVRPP-ja Tiranë ka konstatuar se sipërfaqja e banesës ishte saktësuar nga 136 m² në 119 m², korrigjim i kryer gjatë procedurave të regjistrimit të pallatit ku banonte, bazuar në verifikimet e kryera në vend nga ZVRPP-ja Tiranë për të gjithë apartamentet e pallatit.

1.21. Paraqitja nga ana e shitësit B.Q. dhe A.D. e sipërfaqes nga 119 m² në 136 m² mund të ketë lidhje me metodën e përlllogaritjes së sipërfaqes në bashkëpronësi në kohën kur ata kanë blerë këtë apartament. Mundet që në atë kohë në sipërfaqen e apartamentit të përlllogaritej edhe pjesa takuese nga sipërfaqja e mjediseve të përbashkëta si shkallët dhe korridoret e pallatit.

1.22. **Në lidhje me mungesën e dokumentacionit provues ligjor për kalimin e transaksionit të pagesës së shumës së blerjes prej 4.000.000 lekësh, subjekti shpjegoi se në vitin 2004 kur ai ka depozituar deklaratën vjetore të vitit 2003 pranë ILDKPKI-së, nuk ka ekzistuar një detyrim formal i shkruar që të depozitoja një dokument justifikues.**

1.23. Më tej, subjekti shpjegon se për shkak të kalimit të një periudhe relativisht të gjatë si dhe procedurave të dorëzimit të dokumenteve pranë ILDKPI-së që zbatoheshin në vitin 2004 në kohën e dorëzimit të deklaratës, aktualisht është e pamundur për të përcaktuar saktë shkaqet e kësaj mungese.

1.24. Edhe pse nuk ka dokumente që vërtetojnë me siguri kalimin e shumës në favor të shitësit, ka indice që tregojnë se likuidimi i shitësit duhet të jetë kryer përmes Bankës së Kursimeve. **Indicia e parë** gjendet tek vetë teksti i kontratës së shitblerjes ku shprehet se likuidimi i pagesës në favor të shitësit do të kryhet përmes Bankës së Kursimeve. **Indicia e dytë** vjen nga informacionet e zyrës noteriale që ka përpiluar kontratën e shitblerjes sipas të cilës mënyra e redaktimit rreth kryerjes së pagesës ka synuar të shprehë se vullneti i palëve ka qenë që likuidimi i shumës së pagesës për shitësin do të kryhej përmes Bankës së Kursimeve.

1.25. **Komisioni, pasi shqyrtoi dhe analizoi shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit arrin në përfundimin se:**

1.26. Subjekti i rivlerësimit ka pasur mospërputhje në deklarin e sipërfaqes së apartamentit, por që nga shpjegimet e dhëna prej tij për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit shpjegoi bindshëm se përse kishin ndodhur këto pasaktësi në deklarin në lidhje me sipërfaqen e apartamentit. Komisioni i konsideron këto shpjegime të mjaftueshme dhe që konfirmojnë se këto pasaktësi kanë lidhje me procesin e regjistrimit të apartamentit duke filluar që nga ndërtimi dhe deri në kolaudimin dhe më tej regjistrimin e objektit, sipas rregullores së regjistrimit të pronave nga hipoteka.

1.27. **Në lidhje me mungesën e dokumentacionit justifikues ligjor për kalimin e transaksionit të pagesës së shumës së blerjes prej 4.000.000 lekësh**, Komisioni, bie dakord me shpjegimin e dhënë nga subjekti i rivlerësimit se edhe pse nuk ka dokumente që vërtetojnë me siguri kalimin e shumës në favor të shitësit, ka indice që tregojnë se likuidimi i shitësit është kryer përmes Bankës së Kursimeve. **Indicia e parë** gjendet tek vetë teksti i kontratës së shitblerjes ku shprehet se likuidimi i pagesës në favor të shitësit do të kryhet përmes Bankës së Kursimeve. **Indicia e dytë** vjen nga informacionet e zyrës noteriale që ka përpiluar kontratën e shitblerjes sipas të cilës mënyra e redaktimit rreth kryerjes së pagesës ka synuar të shprehë se vullneti i palëve ka qenë që likuidimi i shumës së pagesës për shitësin do të kryhej përmes Bankës së Kursimeve.

1.28. Komisioni, arrin në përfundimin edhe pse subjekti nuk solli dokumentacion justifikues ligjor për kalimin e shumës prej 4.000.000 lekësh të shitësit, referuar indiceve të përmendura më lart dhe fakti që subjekti i rivlerësimit e ka regjistruar këtë apartament pranë ZVRPP-së Tiranë, tregon se kjo pagesë është kryer përkundjet shitësve.

1.29. Në lidhje me mungesën e burimeve financiare në shumën prej 65.541 lekësh për vitin 2003, Komisioni, është i mendimit se kjo shumë mund të konsiderohet si shumë e cila sipas analizës është minus, por sipas një analizës logjike, mund të konsiderohet si pasaktësi në deklarin por pa shkaktuar pasojat që kërkon ligji nr. 84/2016.

1.30. **Si konkluzion**, për sa më lart arsyetuar në lidhje me këtë apartament, Komisioni, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit:

- i. arriti të shpjegojë bindshëm të kundërtën e faktit të konstatuar se ka mospërputhje në deklarin e sipërfaqes së apartamentit;

- ii. arriti të shpjegojë bindshëm se shuma prej 4.000.000 lekësh i ishte kaluar shitësve dhe pse pa një dokument ligjor provues;
- iii. kishte burime financiare të ligjshme për blerjen e këtij aseti me anë të huas.

2. Për depozitën bankare pranë “Raiffeisen Bank”, në shumë 2.500.000 lekë dhe gjendjen *cash* në shumë prej 950.000 lekësh.

a. Komisioni, për vërtetimin e faktit dhe burimit të të ardhurave, administroi nga institucionet:

- 2.1 Deklaratën “Vetting” të vitit 2017, dorëzuar nga subjekti i rivlerësimit pranë ILDKPKI-së, më datë 30.01.2017, si dhe dokumentacionin bashkëlidhur.
- 2.2 Deklaratat e Interesave Privatë Periodike Vjetore, të viteve 2006 - 2016.
- 2.3 Dokumentacionin e administruar nga Prokuroria e Përgjithshme, të gjitha bankat e nivelit të dytë dhe Drejtoria e Përgjithshme e Pastrimi i Parave².
- 2.4 Kontratë depozite me afat për individë, nr. ***, me vlerën 2.500 000 lekë, me afat 1 vjeçar, pranë “Credins Bank”.
- 2.5 Dokumentacionin e administruar nga “Raiffeisen Bank”³.
- 2.6 Dokumentacionin e administruar nga “Credins Bank”⁴.

b. Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me ligjin e zbatueshëm.

2.7 Në deklaratën “Vetting” të vitit 2017, subjekti i rivlerësimit deklaroi se ka gjendje *cash*, shumën prej 950.000 lekësh, pjesë nga kursimet në vite prej burimeve të të ardhurave të deklaruara në këtë deklaratë, përkatësisht rroga në detyrat shtetërore të kryera dhe shpërblimeve të përfituara nga veprimtaria e mësimdhënies.

2.8 Po në të njëjtën deklaratë, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar depozitë bankare shumën prej 2.500.000 lekësh, pranë “Raiffeisen Bank” në lekë, pjesë nga kursimet në vite përkatësisht rroga në detyrat shtetërore të kryera dhe shpërblimeve të përfituara.

2.9 Në deklaratimet e tij në përgjigje të pyetësorit të drejtuar nga Komisioni, më datë 07.05.2018⁵, subjekti i rivlerësimit deklaroi se gjendja *cash* në fund të vitit duke llogaritur si të ardhura llotot sportive, është si më poshtë:

- ✓ në vitin 2006 ka pasur shumën 489.591 lekë, duke përfshirë të ardhurat nga llotaria sportive në shumën prej 400.000 lekësh;
- ✓ në vitin 2007 ka pasur shumën 1.368.966 lekë, duke përfshirë të ardhurat nga llotaria sportive në shumën prej 200.000 lekësh;

² Shkresa me nr. *** prot., datë 01.02.2018, nga “Raiffeisen Bank” me të cilën konfirmohet se, z. Artur S. Selmani, nuk disponon llogari në këtë bankë. Z. Artur Selmani ka pasur llogari dy-emërore edhe në emër të znj. A.S., të cilat aktualisht janë të mbyllura. Znj. A.B.S. ka qenë kliente e bankës dhe ka pasur llogari. Znj. G.A.S. ka llogari në lekë me gjendje 5.000 lekë. Znj. D.S.S. ka qenë kliente e bankës, ka pasur llogari të cilat aktualisht janë të mbyllura.

Shkresa me nr. *** prot., datë 09.02.2018, ardhur nga “Credins Bank”, me të cilën konfirmohen si klientë të “Credins Bank” z. Artur S. Selmani, znj. A.B.S., znj. E.A.S.

³ Shkresa nr. *** prot., datë 01.02.2018, nga “Raiffeisen Bank”.

⁴ Shkresa nr. *** prot., datë 09.02.2018, nga “Credins Bank”.

⁵ E-mail-i i datës 07.05.2018.

- ✓ në vitin 2008 ka pasur shumën 2.279.582 lekë, duke përfshirë të ardhurat nga llotaria sportive në shumën 400.000 lekësh;
- ✓ në vitin 2008 ka pasur shumën 2.279.582 lekë, duke përfshirë të ardhurat nga llotaria sportive në shumën prej 400.000 lekësh.

2.10 **Në deklaratimet e tij në përgjigje të pyetësorit të drejtuar nga Komisioni**, më datë 19.10.2018, subjekti i rivlerësimit deklaroi se gjendja *cash* në fund të vitit duke llogaritur këto të ardhura, është si më poshtë:

- ✓ në vitin 2009 ka pasur shumën 3.163.821 lekë, duke përfshirë dhuratë nga nëna, shumën prej 475.200 lekësh;
- ✓ në vitin 2010 ka pasur shumën 3.774.987 lekë, duke përfshirë dhuratë nga motra në shumën 360.000 lekë dhe dhuratë nga nëna, shumën prej 475.200 lekësh;
- ✓ në vitin 2011 ka pasur shumën 4.186.979 lekë, duke përfshirë dhuratë nga motra në shumën 360.000 lekë dhe dhuratë nga nëna, shumën prej 100.000 lekësh;
- ✓ në vitin 2012 ka pasur shumën 4.814.883 lekë, duke përfshirë dhuratë nga motra në shumën 360.000 lekë dhe dhuratë nga nëna, shumën prej 100.000 lekësh;
- ✓ në vitin 2013 ka pasur shumën 5.201.356 lekë, duke përfshirë dhuratë nga motra në shumën 240.000 lekë dhe dhuratë nga nëna, shumën prej 100.000 lekësh;
- ✓ në vitin 2014 ka pasur shumën 4.545.490 lekë, duke përfshirë dhuratë nga motra në shumën 180.000 lekë dhe dhuratë nga nëna, shumën prej 180.000 lekësh;
- ✓ në vitin 2015 ka pasur shumën 4.440.034 lekë, duke përfshirë dhuratë nga nëna, në shumën prej 150.000 lekësh.

2.11 Subjekti i rivlerësimit për vitin 2016, ka deklaruar se gjendja e plotë *cash* e gjeneruar ndër vite, përfshirë edhe vitin 2016 është në shumën 3.450.000 lekë. Shuma prej 950.000 lekësh përfaqëson diferencën e gjendjes së plotë të *cashit* të gjeneruar ndër vite, e cila ka mbetur si *cash* në banesë pas depozitimit të shumës 2.500.000 lekë pranë “Credins Bank”.

2.12 **Nga hetimi administrativ u konstatua se** subjekti i rivlerësimit ka depozituar *cash*, shumën prej 2.500.000 lekësh, me përshkrim “Derdhje *cash* të ardhura nga puna” dhe i ka vendosur depozitë me afat sipas shkresës së dërguar nga “Credins Bank”.

2.13 Sipas deklaratimeve të subjekti të rivlerësimit në deklaratë “Vetting” dhe në përgjigje të pyetësorit të tetorit 2018, shuma prej 2.500.000 lekësh, është derdhur *cash* në bankë dhe është krijuar depozitë duke pakësuar gjendjen e likuiditeteve *cash* në shtëpi, si më poshtë:

- ✓ Gjendje *cash*, më datë 31.12.2015, shuma prej 3.444.645 lekësh.
- ✓ Gjendja *cash*, më datë 31.12.2016, shuma prej 944.645 lekësh (3.444.645 - 2.500.000), shumë kjo afërsisht e barabartë me deklarimin në deklaratën “Vetting” të gjendjes *cash* në shumën prej 950.000 lekësh.

2.14 Në lidhje me likuiditetet e vitit 2006, Komisioni, konstaton se subjekti i rivlerësimit ka depozituar në “Raiffeisen Bank” nga gjendja *cash* shumën prej 4024 USD, shumë e cila është krijuar nga fitimet në llotari sportive gjatë vitit 2006, në shumën 4.000 USD.

2.15 Në lidhje me likuiditetet e vitit 2007, subjekti ka deklaruar të ardhura nga fitimi në llotari sportive në shumën prej 2.000 USD dhe sipas deklaratimeve të subjekti të rivlerësimit në përgjigje të pyetësorit të datë 19.10.2018, kjo shumë ka qenë burim për krijimin e gjendjes *cash* nga ana e subjekti për vitin 2007.

2.16 Në lidhje me likuiditetet e viti 2008, subjekti ka deklaruar: (i) Të ardhura nga fitimi në llotari sportive në shumën 4.000 USD ose të konvertuar në lekë 363.840 lekë; (ii) Të ardhura nga pensioni i nënës D.S., në shumën 330 euro në muaj, gjithsejtë 3.960 euro ose 487.803 lekë (të konvertuar me 123.18 lekë/euro kursi i këmbimit të Bankës së Shqipërisë). Sipas deklarimeve të subjektit këto të ardhura kanë shërbyer si burim për krijimin e gjendjes *cash* në fund të vitit 2008 dhe për rrjedhojë krijimin e depozitës bankare në shumë prej 2.500.000 lekësh dhe gjendje *cash* në shumë prej 950.000 lekësh të deklaruara në deklaratën “Vetting” të vitit 2017.

2.17 Në lidhje me të ardhurat nga llotot sportive për vitet 2006 - 2008, subjekti i rivlerësimit nuk provoi me dokumentacion justifikues ligjor, këto të ardhura në shumën totale prej 10.000 USD, shuma të cilat kanë shërbyer si burim për krijimin e depozitës dhe gjendjes *cash*.

2.18 **Në lidhje me dhurata të bëra nga motra e subjektit, znj. T.S., nëna e subjektit, znj. D.S., si dhe kushëriri, z. Y.M, u konstatua se subjekti ka deklaruar:**

- ✓ **Për vitin 2009** - dhuratë në shumën 2.000 euro nga motra T.A. dhe dhuratë në shumën 500 euro nga kushëriri Y.M.
- ✓ **Për vitin 2010** - dhuratë në shumën 3.000 euro nga motra T.A. dhe pensioni në *cash* i nënës D.S., në shumën 3.960 euro.
- ✓ **Për vitin 2011** - para *cash* nga motra T.A. në shumën 3.000 euro dhe pensioni i pleqërisë i nënës së subjektit D.S., në shumën prej 100.000 lekësh.
- ✓ **Për vitin 2012** - para *cash* nga motra T.A., në shumën 3.000 euro dhe pensioni i pleqërisë i nënës së subjektit D.S., në shumën 100.000 lekë.
- ✓ **Për vitin 2013** - dhuratë *cash* nga motra T.A., në shumën 2.000 euro dhe pensioni i pleqërisë i nënës së subjektit D.S., në shumën 100.000 lekë.
- ✓ **Për vitin 2014** - pagesa e udhëtimit në Itali nga motra e subjektit, znj. T.A., në *cash* në shumën 1.500 euro; para *cash* nga motra e subjektit, në shumën 1500 euro dhe para në *cash* nga nëna e subjektit, znj. D.S., pensione, në shumën 150.000 lekë.
- ✓ **Për vitin 2015** - Pjesë nga pensioni i pleqërisë nga nëna e subjektit, znj. D.S., në shumën 150.000 lekë.

2.19 Subjekti i rivlerësimit, më datë 19.10.2018, ka deklaruar se dhuratat nga motra e subjektit, znj. T.S. dhe nëna e subjektit, znj. D.S., kanë shërbyer si burim krijimi për depozitën e çelur në “Credins Bank”, në shumën 2.500.000 lekë dhe gjendjen *cash* në shumën 950.000 lekë, të cilat janë deklaruar në deklaratën “Vetting”.

2.20 Subjekti i rivlerësimit nuk justifikon me dokumentacion ligjor provues, të ardhurat e ligjshme të personit tjetër të lidhur/motrës, znj. T.S., të ardhura të cilat kanë shërbyer si burim për dhuratat që i ka dërguar subjektit të rivlerësimit nga viti 2009 deri në vitin 2014.

2.21 Motra e subjektit, znj. T.S., si dhe bashkëshorti i saj, z. A.A., dërguan si dokumentacion justifikues ligjor: i) Certifikatën e martesës me z. A.A.; ii). Dokument mbi të ardhurat personale të saj për vitin 2014 - 2015; iii) Karta e identitetit të motrës së subjektit; iv) Karta e identitetit të bashkëshortit të motrës së subjektit; v) Deklaratën me shkrim të motrës së subjektit, znj. T.S., që konfirmon dhënien e dhuratave të deklaruara në deklaratat periodike të të ardhurave të krijuara për vitet 20014 - 2015.

2.22 **Komisioni konstatoi mospërputhje në lidhje me** shkakun e dhurimit, pasi subjekti i rivlerësimit deklaroi se nëna e tij gjatë periudhës që motra i dhuronte euro (2009 - 2014), ka

jetuar dhe vazhdon të jetojë edhe aktualisht në familjen e motrës T.S., me banim në Itali, ndërsa motra e subjektit, znj. T.S., deklaron në deklaratën e datës 07.05.2018, se : *“Këto dhurata (euro) i kam dhënë që familja e vëllait tim të ndihmohej për shpenzimet që mund të bënte për nënën gjatë qëndrimit të saj në Tiranë”*. Më tej subjekti vetëdeklaron se këto dhurata i ka përdorur për të krijuar depozitën prej 2.500.000 lekësh me afat 1-vjeçar pranë “Credins Bank”.

2.23 Subjekti i rivlerësimit në shpjegimet e tij përfundimtare dhe në seancë dëgjimore në lidhje me këtë konstatim shpjegoi se:

2.24 Konkluzioni i arritur në relacion se ky deklaram i motrës së subjektit, znj. T.S., rreth origjinës së të ardhurave të saj, nuk përputhet me regjimin martesor me pasuri të ndarë, bazohet në natyrën e veçantë të këtij regjimi martesor sipas të cilit asnjëri prej bashkëshortëve nuk ka të drejtë të administrojnë apo përdorin të ardhurat që i përkasin vetëm bashkëshortit tjetër, pa dijeninë dhe miratimin e tij. Më tej ai shpjegon se ka qenë gjithmonë i qartë se këto dhurata të motrës së subjektit, znj. T.S., përfaqësonin jo thjesht dhuratat e saj personale drejtuar subjektit, si vëllai i saj, por dhurata në emër të familjes së saj në favor të familjes sime.

2.25 Për të vërtetuar këtë deklaram, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur si provë deklaratën e z. A.A., ku shprehet se dhuratat e dërguara nga motra e tij, janë bërë gjithmonë me miratimin dhe dijeninë e bashkëshortit të saj, duke i cilësuar ato si dhurata familjare në emër të familjes A. për subjektin e rivlerësimit dhe familjen e tij.

2.26 Subjekti gjatë seancës dëgjimore, shpjegoi gjithashtu se mund të ketë ndonjë keqkuptim nga ana e tij në lidhje me kërkesën për të dërguar dokumentacion shtesë për të ardhurat e motrës së tij, pasi ai mendon se gjithçka është dërguar pranë ILDKPKI-së.

2.27 Si konkluzion, të shpjegimeve të tij subjekti i rivlerësimit shpjegon se pavarësisht nga regjimi martesor me pasuri të ndarë, motra e subjektit, znj. T.S., e ka të justifikuar burimin e të ardhurave që ajo ka përdorur për të bërë dhurata familjare në adresë të familjes sime pasi ato rezultojnë se janë bërë me dijeni dhe miratim të plotë të bashkëshortit të saj, z. A.A.

2.28 Në lidhje me rezultatet e tjera të dala nga hetimi për (i) mosprovueshmërinë me dokumentacion justifikues ligjor të shumave që kishte fituar në llotaritë sportive për vitet 2006, 2007 dhe 2008, (ii) mos justifikimin me dokumentacion ligjor provues, të të ardhurave të ligjshme të saj që kanë shërbyer si burim për dhuratat që i ka dërguar subjektit të rivlerësimit nga viti 2009 deri në vitin 2014, dhurata të cilat kanë shërbyer si burim për krijimin e depozitës dhe gjendjes *cash* (iii) mos justifikimin me dokumentacion ligjor provues, të të ardhurave të ligjshme të motrës së subjektit që kanë shërbyer si burim për dhuratat që i ka dërguar subjektit.

2.29 Subjekti i rivlerësimit dërgoi një akt ekspertim kontabël, të datës 18.11.2018, përgatitur nga z. E.K., “Kontabël i miratuar” me dëshmi profesionale, nr. ***, datë 16.02.2006.

2.30 Komisioni, pasi shqyrtoi dhe analizoi shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit arrin në përfundimin se:

2.31 Subjekti i rivlerësimit ka mungesë të dokumentacioni ligjor justifikues për burimin e krijimit të depozitës në shumën prej 2.500.000 lekësh në “Credins Bank” dhe gjendjen *cash* në shumë prej 950 000 lekësh.

Në lidhje me burimin nga të ardhurat e fituara në llotari sportive.

2.32 Referuar nenit D, pikës 3 të Aneksit të Kushtetutës specifikohet se: *“Subjekti i rivlerësimit duhet të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave.”*

2.33 Subjekti rivlerësimit nuk paraqiti dokumentacion justifikues që të vërtetonte të ardhurat nga llotaritë sportive në shumën prej 10.000 USD fituar gjatë viteve 2006 - 2008, të ardhura që kishin shërbyer si burim për krijimin e depozitës dhe gjendjes *cash*, deklaruar në deklaratën “Vetting” të vitit 2017.

2.34 Lidhur me shpjegimin e subjektit të rivlerësimit se nuk kishte ruajtur dokumentacionin që vërteton të ardhurat e krijuara nga pjesëmarrja në llotari sportive për periudhën 2007 - 2009, si p.sh kopje të biletave të llotarisë apo të faturave tatimore për shkak se pasi ka depozituar deklaratimet mbi të ardhurat vjetore pranë ILDKPKI-së, për vitet përkatëse 2006, 2007 dhe 2008, në asnjë rast nuk më i është komunikuar nga ILDKPKI-ja se dokumentacioni justifikues i deklaratës së të ardhurave vjetore ishte i paplotë, Komisioni, çmon se ky shpjegim nuk përbën shkak për të justifikuar mungesën e dokumentacioni ligjor provues në lidhje me këto të ardhura. Për më tej, subjekti nuk provoi se ishte në kushtet pamundësisë për të vërtetuar këto të ardhura.

2.35 Një problem themelor me bastet sportive nga ana e lojtarit në përgjithësi është humbja e parave në mënyrë periodike, për shkak se është e pamundur të parashikohet çdo ndeshje dhe të fitohet gjithmonë. Pra dhe fitimi i deklaruar i tij merret me rezervë deri në momentin kur nuk deklarohen humbjet.

2.36 **Si konkluzion**, subjekti rivlerësimit ka mungesë të dokumentacionit ligjor justifikues për të vërtetuar këto të ardhura nga llotaritë sportive në shumën prej 10.000 USD fituar gjatë viteve 2006 - 2008, të ardhura që kishin shërbyer si burim për krijimin e depozitës dhe gjendjes *cash*, deklaruar në deklaratën “Vetting” të vitit 2017.

Në lidhje me shumat e dhuruara nga motra e subjektit, znj. T.S. dhe nëna e subjektit, znj. D.S.

2.37 Sipas nenit 3, pika 14, e ligjit nr. 84/2016 *“Persona të tjerë të lidhur” janë personat fizikë ose juridikë, që duket se kanë ose kanë pasur lidhje interesi me subjektin e rivlerësimit, komisionerin, gjyqtarin ose komisionerin publik që rrjedh nga një interes pasuror ose çdo marrëdhënie tjetër biznesi”*.

2.38 Motra e subjektit të rivlerësimit, znj. T.S. dhe nëna e subjektit, znj. D.S., janë persona të tjerë të lidhur në kuptim të nenit 3, pika 14, e ligjit nr. 84/2016, pasi nga deklaratimet dhe rrethanat e çështjes del qartë se ato kanë pasur marrëdhënie interesi me subjektin e rivlerësimit që rrjedh nga një interes pasuror siç është dhurimi që ato i kanë bërë subjektit të rivlerësimit, respektivisht T.S., në shumën prej 16.950 eurosh dhe D.S. në shumën prej 600.000 lekësh dhe 11.880 Euro.

2.39 Referuar nenit 32, pika 4, të ligjit nr. 84.2016, specifikon se: *“Subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, ose persona të tjerë të lidhur, të deklaruar në cilësinë e dhuruesit, huadhënësit ose huamarrësit, nëse konfirmojnë këto marrëdhënie, kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive.”*

2.40 Duke qenë se znj. T.S. dhe znj. D.S. janë persona të tjerë të lidhur, dhe marrëdhënia e tyre e dhurimit është konfirmuar nga palët, ato kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të dhuratave që i janë bërë subjektit të rivlerësimit.

2.41 Motra e subjektit të rivlerësimit, znj. T.S. dhe bashkëshorti i saj nuk provuan me dokumentacion ligjor se kishin mjaftueshëm të ardhura nga burime të ligjshme, nga viti 2009 – 2013, për të bërë dhurata subjektit të rivlerësimit, sipas nenit 32, pika 4, të ligjit nr. 84/2016.

Ata paraqitën dokumentacion provues për të ardhurat e vitit 2014 -2 015 respektivisht për shumën prej 3.000 eurosh, vetëm pas kërkesës nga Komisioni me anë të pyetësorit.

2.42 Deklarata e z. A.A., bashkëshortit të mortës së subjektit, *se dhuratat e dërguara nga motra e subjektit, janë bërë gjithmonë me miratimin dhe dijeninë e tij, duke i cilësuar ato si dhurata familjare në emër të familjes A. për subjektin dhe familjen e tij*, nuk provon se motra e subjekti dhe bashkëshorti i saj kanë të ardhura për të bërë këto dhurata në vitet 2009 - 2013.

2.43 Ka disa mospërputhje midis deklaramit të bërë nga subjekti i rivlerësimit, i cili deklaroi se nëna e subjektit, në vitet 2009 - 2014, ka jetuar dhe vazhdon të jetojë në familjen e motrës së subjektit, znj. T.S., me banim në Itali, ndërsa vetë motra e subjektit, znj. T.S., deklaroi në deklaratën e datës 07.05.2018 se : *“Këto dhurata (euro) i kam dhënë që familja e vëllait tim të ndihmohej për shpenzimet që mund të bënte për nënën gjatë qëndrimit të saj në Tiranë”*, ndërkohë që subjekti i rivlerësimit deklaroi se me këto para të dhuruara ka krijuar depozitën në shumën prej 2.500.000 lekësh.

2.44 Subjekti i rivlerësimit, në lidhje me dhurimin në shumën 11.880 euro dhe 600.000 lekë bërë nga nëna e tij , znj. D.S., e cila i kishte përfituar nga pensioni në shtetin Italian dhe atë shqiptar, subjekti solli dokumentacion justifikues duke vërtetuar shumën mujore që ajo merret nga pensioni.

2.45 Për sa i përket shpjegimit të subjektit gjatë seancës dëgjimore, se ai mendon se dokumentacioni justifikues për të ardhurat e motrës është dërguar pranë ILDKPKI-së, ky shpjegim nuk qëndron, pasi dokumentacioni i dorëzuar pranë ILDKPKI-së nuk na rezulton të ketë dokumentacion ligjor provues për të justifikuar të ardhurat e z. A.A.

2.46 **Si konkluzion**, subjekti i rivlerësimit nuk shpjegoi bindshëm burimin e ligjshëm të të ardhurave nga dhuratat e bëra nga motra e subjektit, znj. T.S. dhe për pasojë ka mungesë të burimeve të ligjshme financiare me dokumentacion justifikues për këto dhurata të bëra gjatë viteve 2009 - 2013, në vlerën 13.950 euro.

3. Transferta të kryera nga subjekti apo personat e lidhur me të, nëpërmjet Unionit Financiar të Tiranës.

a. Komisioni, për vërtetimin e faktit, administroi nga institucionet:

3.1 Dokument shkresor nga ana e “AK Invest” institucion financiar, ku konfirmonte se shtetasi Artur Selmani dhe personi i lidhur/bashkëshortja, znj. A.S.⁶ kanë kryer tranferta parash hyrëse dhe dalëse me “AK Invest”.

3.2 Dokument shkresor nga ana e Union Financiar Tiranë, ku konfirmon se, z. Artur Selmani, ka pasur një transaksion në hyrje në shumën 950 euro⁷.

3.3 Dokument shkresor depozituar nga ana e subjektit nga “AK Invest” institucion financiar⁸.

b. Arsytimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me ligjin e zbatueshëm.

⁶ Shkresa me nr. *** prot., datë 17.07.2018, nga “AK Invest”, institucion financiar.

⁷ Shkresa me nr. *** prot., datë 20.07.2018, nga Unioni Financiar Tiranë.

⁸ Shkresa me nr. *** prot., datë 07.11.2018, nga “AK Invest” institucion financiar.

3.4 Nga hetimi administrativ u konstatua se ka pasur një transaksion në hyrje në emrin e subjekti, në total në vlerën 950.50 euro dhe ai ka tërhequr gjithsej vlerën 950.50 euro nëpërmjet Unionit Financiar të Tiranës.

3.5 Nga “AK Invest” institucion financiar, rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka kryer dërgesa dhe tërheqje jashtë territorit të Shqipërisë, nga shteti i Belgjikës, Mbretërisë së Bashkuar, Gjermanisë dhe Italisë, por pa përcaktuar shumat pasi ai nuk ishte klient i këtij unioni financiar për vitet 2013 - 2018.

3.6 Personi i lidhur/ bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit, znj. A.S., jo klient i “AK Invest” ka kryer dërgesa dhe tërheqje jashtë territorit të Shqipërisë, nga shteti i Belgjikës dhe Gjermanisë.

3.7 Nga deklaratimet e bëra nga ana e subjektit të rivlerësimit në tetor 2018, subjekti deklaroi se nuk ishte në dijeni të këtyre transaksioneve.

3.8 Subjekti i rivlerësimit në shpjegimet e tij përfundimtare dhe në seancë dëgjimore në lidhje me këtë konstatim shpjegoi se:

3.9 Në lidhje me kryerjen e një transaksion në total në vlerën 950.50 euro, shumë e cila është tërhequr nga ana e subjektit nëpërmjet Unionit Financiar të Tiranës, subjekti deklaroi se ishte e vërtetë që ka tërhequr këtë shumë përmes Western Union, dhe për këtë transaksion paraqiti edhe dokumentin ligjor justifikues.

3.10 Shuma në fjalë siç del edhe nga vetë transaksioni i është dërguar nga motra e subjektit, znj. T.S., si dhuratë e saj familjare në favor të familjes së subjektit.

3.11 Në lidhje me konstatimin se përmes Unionit Financiar “AK Invest”, në periudhën 2013 - 2018, subjekti ka kryer dërgesa dhe tërheqje jashtë territorit të Shqipërisë, nga shteti i Belgjikës, Mbretërisë së Bashkuar, Gjermanisë dhe Italisë, pa përcaktuar shumat konkrete. Po kështu dhe bashkëshortja e subjektit, znj. A.S., ka kryer përmes “AK Invest” dërgesa dhe tërheqje jashtë territorit të Shqipërisë, nga shteti i Belgjikës dhe Gjermanisë, subjekti i rivlerësimit deklaroi me bindje dhe përgjegjësi se as ai dhe as bashkëshortja e tij, znj. A.S., nuk kanë kryer asnjëherë transaksione financiare, dërgesa apo tërheqje të hollash nga apo për jashtë shtetit, përmes institucionit financiar “AK Invest”.

3.12 **“AK Invest”, me shkresën nr. *** , datë 07.11.2018**, konfirmon se nuk i rezultojnë asnjë rast që përmes “AK Invest” të jenë kryer transaksione financiare nga një person me emrin Artur Selmani, identifikuar me ID e tij apo A.S., identifikuar me ID e bashkëshortes së subjektit. Po kështu “AK Invest” deklaroi, se nuk e ka konfirmuar asnjëherë se emri i subjektit dhe i bashkëshortes së subjektit (të përmendur në transaksionet e kryera nga klientët e saj), është identifikuar nga “AK Invest” se kanë qenë pikërisht Artur Selmani me ID e tij dhe A.S. me ID e saj. Ato emra përfaqësojnë vetëm emrat që klientët e identifikuar të “AK Invest” i kanë deklaruar si personat në favor të të cilëve apo me të cilët kryheshin prej tyre transaksionet përkatëse. Për këtë arsye “AK Invest” ka garantuar në informacionin që ka dhënë vetëm vërtetësinë e identitetit të personit “klient” që paraqitet në sportelet e saj, por jo edhe identitetin e saktë të personave që prej klientëve janë deklaruar vetëm me emër mbiemër, si Artur Selmani apo A.S.

3.13 Saktësia e identitetit të personave të përmendur si Artur Selmani apo A.S. nga klientët e “AK Invest” garantohet vetëm nga “MoneyGram” me seli në SHBA dhe jo nga vetë “AK Invest”.

3.14 Nga sistemi *TIMS* del qartë se unë dhe bashkëshortja e subjektit nuk rezultojn të ketë qenë ndonjëherë në Belgjikë, Mbretërinë e Bashkuar apo Gjermani për periudhën kohore 2013 - 2018.

3.15 Nga sistemi *TIMS* del se mbajnë të njëjtin emër dhe mbiemër si unë dhe bashkëshortja ime edhe shumë persona të tjerë me të njëjtin identitet Artur Selmani, 12 persona dhe A.S., 8 persona.

3.16 Komisioni, pasi shqyrtoi dhe analizoi shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit arrin në përfundimin se:

3.17 Subjekti i rivlerësimit arriti të provojë burimin e të ardhurave prej 950.50 eurosh të tërhequra nëpërmjet Unionit Financiar Tirana, por nuk arriti të provojë me dokumentacion ligjor provues se motra e subjektit i kishte këto të ardhura nga burime të ligjshme.

3.18 Subjekti i rivlerësimit me anë të shkresën, nr. ***, datë 07.11.2018, të “AK Invest”, arriti të provojë se nuk ishte ai dhe bashkëshortja e tij (me ID përkatëse) që kishin kryer këto transaksione, siç dhe janë konstatuar nga ana e Komisionit.

3.19 **Si konkluzion**, subjekti i rivlerësimit ka mungesë të dokumentacionit ligjor justifikues për të provuar se motra e tij, znj. T.S., ka pasur të ardhura nga burime të ligjshme për të bërë dhuratën në shumën prej 950.50 eurosh; dhe

3.20 Subjekti i rivlerësimit shpjegoi bindshëm dhe provoi edhe që personat me të njëjtin emër dhe mbiemër me të dhe bashkëshorten e tij, kishin kryer transaksione me Unionin Financiar, “AK Invest”, por që nuk ishin të njëjtët persona me subjektin dhe bashkëshorten e tij, vërtetuar kjo me kartën e identitetit dhe letrën e dërguar nga “AK Invest”.

4. Deklarimi i të ardhurave nga angazhimi në përgatitjen e revistës “**”, projekt i qendrës L.I.S.T. Shuma 954 167 lekë .**

a. Komisioni, për vërtetimin e faktit dhe burimit të të ardhurave, administroi nga institucionet:

4.1 “Deklarata e Interesave Private, Vetting” për vitin 2017.

b. Arsytimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me ligjin e zbatueshëm.

4.2 Në deklaratën “Vetting” të vitit 2017, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se ka fituar të ardhura nga angazhimi në përgatitjen e revistës “****”, projekt i qendrës L.I.S.T, në shumën 954.167 lekë.

4.3 **Nga hetimi administrativ kryesisht i Komisionit, u konstatua se subjekti i rivlerësimit nuk kishte paraqitur dokumentacion justifikues ligjor në lidhje me këto të ardhura të deklaruara.**

4.4 **Subjekti i rivlerësimit së bashku me shpjegimet e tij përfundimtare**, paraqiti një vërtetim nga qendra L.I.S.T, ku vërtetonte se këto të ardhura ishin marrë nga ana e subjektit të rivlerësimit

4.5 **Komisioni, pasi shqyrtoi dhe analizoi provën e dërguar nga subjekti i rivlerësimit arrin në përfundimin se** subjekti i rivlerësimit arriti të provojë se këto të ardhura ishin marrë nga angazhimi në përgatitjen e revistës “****”, projekt i qendrës L.I.S.T, në shumën 954. 167 lekë.

4.6 **Si konkluzion**, subjekti i rivlerësimit arriti të provojë me dokumentacion justifikues ligjor të ardhurat në shumën 954.167 lekë të fituara nga angazhimi në përgatitjen e revistës “***”, projekt i qendrës L.I.S.T.

5. Analiza financiare për vitet 2003 - 2016, duke marrë në konsideratë shpenzimet jetike të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit në tetor 2018

a. Komisioni, për vërtetimin e faktit dhe burimit të të ardhurave, administroi:

5.1 “Deklarata e Interesave Private, Vetting” për vitin 2017, së bashku me dokumentacionin bashkëlidhur.

5.2 Deklaratën e Interesave Private, deklarim për herë të parë, në vitin 2003 nënshkruar nga subjekti i rivlerësimit.

5.3 Deklaratat e Interesave Private Periodike, për vitet 2004 - 2016, nënshkruar nga subjekti i rivlerësimit.

5.4 Deklarimet e bëra në përgjigjet e tetorit të vitit 2018, dërguar në formën e aneksit 1, ku kenë përcaktuar shpenzimet jetike për secilin vit.

5.5 Të ardhurat, pasuritë, detyrimet të deklaruara në deklarimet e viteve 2003 - 2016.

5.6 Analizën financiare të përgatitur nga Komisioni.

b. Arsytimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me ligjin e zbatueshëm.

5.7 **Në deklaratën “Vetting” të vitit 2017**, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar të gjitha angazhimet dhe të ardhurat nga puna e tij dhe e bashkëshortes për periudhën 2003 - 2016.

5.8 **Në deklarimet e interesave privatë, deklarim për herë të parë në vitin 2003, subjekti ka deklaruar**, apartament banimi i ndërtuar pas vitit 1995, me sip.130 m², vlera 4.000.000 lekë, pjesa takuese: 100 %, përfituar me kredi, regjistruar në hipotekë në shtator 1999; autoveturë, me vlerë 300.000 lekë, pjesa takuese: 100 %, burimi i krijimit, kursime nga rroga dhe shpërblimet si prokuror; paga e subjektit si prokuror në shumën 1,93 milion lekë; paga e bashkëshortes A. S., 0,21 milion lekë; D.S., nëna e subjektit, të ardhura vjetore nga pensioni 0.08 milion lekë .

5.9 Subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në këtë vit depozitën në emër të nënës së tij, znj. D.S., si dhe gjendjen në “Raiffeisen Bank”, në shumën 1.172.272 lekë si detyrim ligjor për deklarim në vitin 2003.

5.10 **Në deklarimet e interesave private periodike, për vitin 2004 - 2016, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar likuiditetet në fillim dhe në fund të vitit, të ardhurat**, pasuritë, detyrimet, të cilat janë të ndryshme nga ato të paraqitura në aktin e ekspertimit si pjesë e pretendimeve përfundimtare.

5.11 **Nga hetimi administrativ kryesisht i Komisionit, u konstatua se** nga analizimi i deklaratave vjetore mbi të ardhurat, pasuritë, detyrimet dhe shpenzimet (të deklaruara nga ana e subjektit të rivlerësimit në pyetësorin e tetorit të vitit 2018), shpenzimet jetike për ushqim, veshmbathje etj., (duke u llogaritur sipas deklarimit të subjektit pranë Komisioni me *e-mail-in* e datës 22.10.2018.), subjekti i rivlerësimit ka një mungesë të burimeve financiare me dokumentacion justifikues të ligjshëm, në shumën - 3.820.556 lekë, siç përshkruhet në tabelën më poshtë:

Viti	Të ardhurat	Pasuritë	Detyrimet	Shpenzimet	Diferenca
2003	1,712,018	239,559	(228,000)	1,310,000	-65,541
2004	1,944,467	396,075	(228,000)	1,570,000	-249,608
2005	1,948,339	1,132,211	(228,000)	1,510,000	-921,872
2006	1,994,118	870,456	(228,164)	1,510,000	-614,502
2007	2,097,654	(1,087,575)	(228,164)	1,520,000	1,437,065
2008	2,379,356	824,024	(228,164)	1,750,000	-422,832
2009	2,370,301	811,621	(228,164)	1,490,000	-159,484
2010	2,941,642	1,605,187	(228,164)	2,216,000	-1,107,709
2011	2,314,758	366,633	(228,050)	2,130,000	-409,925
2012	2,369,345	618,764	(228,168)	1,985,240	-462,827
2013	2,663,265	502,586	(228,168)	2,100,000	-167,489
2014	2,235,589	(76,308)	(229,165)	2,581,505	-498,773
2015	1,895,531	360,706	(228,083)	2,262,600	-955,858
2016	1,984,101	(1,448,176)	(227,879)	2,425,600	778,798
TOTALI	30,850,484	5,115,762	(3,194,333)	26,360,945	-3,820,556

5.12 **Subjekti i rivlerësimit së bashku me shpjegimet e tij përfundimtare me shkrim paraqiti një akt ekspertimi** nga eksperti kontabël E. K., bazuar në të dhënat e marra nga dosja e hetimit administrative që iu vu në dispozicion nga Komisioni në format elektronik në CD si dhe çdo të dhënë tjetër të mundshme që mund të ndihmonte në këtë drejtim.

5.13 **Sipas subjektit**, në përfundim të përllogaritjeve të kryera nga eksperti kontabël E. K., dhe të sintetizuara në aktin e tij të ekspertimit kontabël të datës 18.11.2018, u arrit në këto konkluzione:

- i. Pasuria e mundshme që mund të krijonte familja ime për periudhën 1996 - 2002 ka qenë deri në vlerën prej 7.300.000 lekësh.
- ii. Nuk rezultojnë diferenca negative mes të ardhurave dhe shpenzimeve nga njëra anë dhe pasurisë së krijuar për periudhën 2003 - 2016 nga ana tjetër.
- iii. Diferencat negative të evidentuara në relacion e kanë bazën e tyre tek mospërfshirja në përllogaritje të :
 - ✓ Të gjendjes së likuiditetit në fillim të vitit 2003, që kishte si origjinë të saj shitjen e apartamentit në vitin 1996 dhe të ardhurat e gjeneruara gjatë periudhës 1996 - 2002.
 - ✓ Të të ardhurave të siguruara prej meje nga Qendra L.I.S.T., në lidhje me shpërblimet e përfituara nga bashkëpunimi shkencor për prodhimin e revistës shkencore “***”.
 - ✓ Të ardhurave të siguruara nga pensioni i pleqërisë në Shqipëri të përfituar nga nëna e subjektit të rivlerësimit/znj.D.S., sipas vërtetimit përkatës të lëshuar nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, Drejtoria Rajonale Tiranë, për periudhën 1996 - 2016.

5.14 **Komisioni, pasi shqyrtoi dhe analizoi provën e dërguar nga subjekti i rivlerësimit arrin në përfundimin se**, subjekti i rivlerësimit ka mungesë të të ardhurave shoqëruar me dokumentacion justifikues ligjor në shumën prej – **3,533,901 lekësh**, për vitet 2003 - 20016.

5.15 Kjo mungesë ka ardhur si rezultat i përdorimit të metodologjisë së mëposhtme:

Duke marrë në konsideratë në analizën financiare të viteve 2003 - 2016:

- i. të ardhurat e siguruara nga Qendra L.I.S.T., në lidhje me shpërblimet e përfituara nga bashkëpunimi shkencor për prodhimin e revistës shkencore “***”;
- ii. të ardhurat e siguruara nga pensioni i pleqërisë në Shqipëri të përfituar nga nëna e subjektit të rivlerësimit, znj. D.S., sipas vërtetimit përkatës të lëshuar nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, Drejtoria Rajonale Tiranë, për periudhën 1996 - 2016;
- iii. të ardhurat dhe shpenzimet e jetike të nënës së subjektit të rivlerësimit për këtë periudhë;
- iv. shpenzimet jetike për person sipas deklarimit të subjektit të rivlerësimit në *e-mail-in* e datës 22.10.2018;
- v. llogaritjet për numër personash sipas aktit të inspektimit.

Duke mos marrë në konsideratë në analizën financiare të viteve 2003 - 2016:

- i. gjendjen e likuiditeteve në fillim të vitit 2003, që sipas subjektit kishte si origjinë të saj shitjen e apartamentit në vitin 1996 dhe të ardhurat e gjeneruara gjatë periudhës 1996 - 2002. Kjo gjendje nuk u mor parasysh pasi në deklaratën e vitit 2003 subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar likuiditete, sipas formularit A-5, në deklarimin për herë të parë në vitin 2003. Për më tepër, subjekti nuk paraqiti dokumentacion ligjor justifikues (akt dhurimi ose ndonjë dokument tjetër) ku nëna e subjektit të deklaronte se këto të ardhura nga shitja e apartamentit në vitin 1996 ajo ja dhuronte subjektit dhe/ose dokument i cili të vërtetonte se nëna i kishte këto lekë në formën e kursimeve;
- ii. likuiditetet në bankë në vitin 2005, në shumën prej 995.896 lekësh, pasi subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur dokumentacion justifikues ligjor për krijimin e këtyre të ardhurave;
- iii. shpenzimet jetike sipas INSTAT-it dhe ILDKPKI-së, pasi subjekti i rivlerësimit ka vetdeklaruar se sa kanë qenë shpenzimet e përafërta për jetesë, referuar kjo *e-mail-it* të datës 22.10.2018.
- iv. mjetet monetare në fillim të vitit 2003, në shumën prej 1.172.272 lekësh, dhe gjendjen e mjeteve monetare në fund të vitit 2003, në shumën prej 1.429.197 lekësh, të paraqitura në analizën financiare për periudhën 1 janar 2003 - 31 dhjetor 2003, në faqen 5 të akt ekspertimit të ekspertit E. K. Këto mjete monetare nuk janë deklaruar në deklaratën për here të parë në vitin 2003 dhe nuk u provuan nga subjekti i rivlerësimit se janë nga shitja e apartamentit.

5.16 **Si konkluzion**, nga analiza aritmetike e viteve të deklarimit nga 2003 deri në vitin 2016, subjekti i rivlerësimit ka një mungesë totale të të ardhurave nga burime të ligjshme në shumën prej - 3.533.901 lekësh, siç paraqitet në tabelën më poshtë:

Viti	Të ardhurat	Pasuritë	Detyrimet	Shpenzimet	Diferenca
2003	1,795,081	239,559	-228,156	1,310,000	17,366
2004	1,908,429	396,075	-228,156	1,570,000	-285,802
2005	2,171,017	28,978	-228,156	1,510,000	403,883
2006	2,104,138	875,811	-228,164	1,510,000	-509,837
2007	2,232,058	-1,161,131	-228,164	1,520,000	1,645,025
2008	2,509,365	824,140	-228,164	1,750,000	-292,939
2009	2,612,530	811,692	-228,164	1,490,000	82,674
2010	3,225,994	1,585,316	-228,164	2,469,540	-1,057,026

2011	2,468,993	345,743	-228,050	2,130,000	-234,800
2012	2,448,231	658,578	-228,168	1,985,240	-423,755
2013	2,746,431	503,321	-228,168	2,100,000	-85,058
2014	2,525,222	408,717	-229,165	2,516,000	-628,660
2015	2,835,464	360,806	-228,083	2,262,600	-16,025
2016	2,995,240	-1,448,175	-227,879	2,425,600	1,789,936
TOTALI	34,525,243	5,115,866	-3,194,801	26,295,440	404,983
Vetëm 9 vitet me bilanc negativ (me minus)					-3,533,901

VI. KONTROLLI I FIGURËS

1. Me shkresën nr. *** prot., datë 27.10.2017, në përputhje me nenin 39, pika 2, i ligjit nr. 84/2016, Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016. Për këtë qëllim, **DSIK-ja ka dërguar një raport për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016**, ku konstaton **papërshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës** nga subjektit të rivlerësimit, për shkak se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar procedimin penal që ka pasur në ngarkim të tij, e ngarkon me përgjegjësinë e fshehjes së faktit dhe plotësimin e pasaktë dhe me vërtetësi të deklaratës së kontrollit të figurës. Më tej si shkak i papërshtatshmërisë nga ana e DSIK-së është konsideruar gjykimi se subjekti mund të vihet nën presion nga struktura kriminale, nga vlerësimi i përgjithshëm të kontrollit të figurës së subjektit të rivlerësimit në zbatim të nenit 37, germa c, e ligjit nr. 84/2016.

2. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, pasi ka analizuar raportin e dërguar nga DSIK-ja, ka konstatuar se një nga shkaqet për të cilat është konstatuar papërshtatshmëria është se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar procedimin penal që ka pasur në ngarkim të tij, e ngarkon me përgjegjësinë e fshehjes së faktit dhe plotësimin e pasaktë dhe me vërtetësi të deklaratës së kontrollit të figurës. Por, duke qenë se procedimi penal në ngarkim të subjektit të rivlerësimit, z. Artur Selmani, është regjistruar nga prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, me nr. *** prot., datë 22.02.2017, dhe dorëzimi i deklaratës për kontrollin e figurës pranë DSIK-së është bërë, më datë 24.01.2017, rezulton se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur dijeni se në ngarkim të tij do të kishte një procedim penal. Për këtë arsye i është kërkuar DSIK-së rishikimi i raportit fillestar të ardhur më datë 27.10.2017.

3. DSIK-ja me shkresën nr. *** prot., datë 18.09.2018, ka dërguar raportin e rishikuar të deklasifikuar mbi kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me konstatimin papërshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës, për shkak se në këndvështrimin e përgjithshëm të kontrollit apo pastërtisë së figurës së një funksionari publik, z. Artur Selmani, në cilësinë e prokurorit, çdo dyshim i arsyeshëm për kryerje ose moskryerje të veprimeve, në kundërshtim me ligjin, në përmbushje të rregullt të detyrës dhe kur këto veprime apo mosveprime sjellin përfitime materiale ose jo materiale të padrejta për vetë këtë funksionar publik apo persona të lidhur me të, duke dëmtuar interesat e ligjshëm të shtetit, apo personave të tjerë, **cenojnë**

figurën e tij, integritetin, shkallën e besueshmërisë dhe e bëjnë këtë individ të mundshëm për t'u vënë nën presion nga strukturat kriminale, sipas germës 'c' të nenit 37 të ligjit nr. 84/2016.

4. **Nga hetimi administrativ kryesisht në lidhje me kontrollin e figurës, Komisioni, konstatoi se:**

5. Subjekti i rivlerësimit në deklarin vjetor të viteve 2006, 2007 dhe 2008 pranë ILDKPKI-së ka deklaruar se ka fituar të ardhura nga pjesëmarrja në llotari sportive, ku ka përfituar shumën 10.000 USD.

6. Subjekti i rivlerësimit, pranë Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë ka kërkuar ndryshimin e vendimit të Gjykatës së Apelit Vlorë, në lidhje me çështjen penale me nr. *** Akti, me të pandehur: A. Ll., A. B., B. A., akuzuar për: kryerjen e veprës penale "Vrasje në rrethana të tjera cilësuese" e kryer ndaj dy ose më shumë personave, të kryera në bashkëpunim, "Prodhim dhe mbajtja pa leje e armëve dhe municioneve luftarake" në ambiente publike, për sa i përket të gjykuari A.Ll., duke e deklaruar atë fajtor për veprën penale të vrasjes nga pakujdesia në dëm të shtetasit A. L., dhe caktimin e një dënimi prej 4 vjet burgim për këtë veprë penale, si dhe i ka kërkuar Kolegjit Penal ti pranojë si të bazuara pretendimet e të gjykuarve duke lënë në fuqi vetëm fajësinë dhe dënimet përkatëse të tyre për veprën penale të armbajtës pa leje.

7. Ndërkohë që **Gjykata e Apelit Vlorë**, me vendimin nr. ***, datë 01.11.2016, ka vendosur: Lënien në fuqi të vendimit nr. ***, datë 20.01.2016, të Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, për sa i përket cilësimit juridik të veprës penale, të parashikuar nga neni 79/dh dhe 25 të Kodit Penal, deklarin të fajësisë për të tre të pandehurit, masat e dënimit për këtë veprë penale, disponimin për provat materiale dhe shpenzimet procedurale. Ndryshimin e vendimit të mësipërm për pjesën tjetër në këtë mënyrë : (i) Deklarimin fajtor të të pandehurit, A, Ll., për veprën penale të parashikuar nga neni 278/3 të Kodit Penal dhe dënimin e tij me 5 vjet burgim. Në aplikim të nenit 55 të Kodit Penal, **dënimin përfundimisht të të pandehurit A. Ll., me burgim të përjetshëm. Në aplikim të nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale, dënimin përfundimisht me 35 vjet burgim.**(ii) Deklarimin fajtor të të pandehurit B. A., për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 278/3 të Kodit Penal dhe dënimin e tij me 5 vjet burgim. Në aplikim të nenit 55 të Kodit Penal **dënimin përfundimisht me 35 vjet burgim. Në aplikim të nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale, urdhërohet ulja e 1/3 së dënimit.** (iii) Deklarimin fajtor të të pandehurit A. B., për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 278/3 të Kodit Penal dhe dënimin e tij me 5 vjet burgim. Në bazë të nenit 55 të Kodit Penal, **dënimin përfundimisht me 35 vjet burgim. Në bazë të nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale, urdhërohet ulja e 1/3 së dënimit.**

8. Nga faktet e njohura botërisht, më datë 21.02.2017, 23, 24 etj., në shkurt 2017 në median e shkruar dhe atë audiovizive është publikuar ankesa të familjarëve të viktimave që kanë mbetur të vrarë, më datë 07.04.2015, në lagjen "Çole", të qytetit Vlorë, duke pretenduar se subjekti ka mbajtur qëndrim të ndryshëm nga prokurorët e Prokurorisë së Shkallës së Parë dhe të Apelit Vlorë, duke lehtësuar akuzat ndaj të pandehurve B. A., A. B., dhe A.Ll.

9. **Subjekti i rivlerësimit në shpjegimet e tij përfundimtare dhe në seancë dëgjimore shpjegoi se:** (i) DSIK-ja nuk ka bërë një hetim të thelluar në lidhje me integritetin e figurës së subjektit në të gjithë komponentët që parashikon ligji nr. 84/2016; (ii) Konkluzioni i arritur nga DSIK-ja mbi papërshtatshmërinë e subjektit për të vazhduar detyrën, qoftë edhe mbi atë

komponent ku ka fokusuar hetimet rreth figurës së tij, është krejtësisht i pabazuar në prova;(iii) DSIK-ja e ka bazuar konkluzionin rreth papërshtatshmërisë së subjektit për të vazhduar detyrën në rrethana që nuk parashikohen nga ligji nr. 84/2016 se mund të përdoren në lidhje me vlerësimin e figurës së magjistratit.

10. **Në lidhje me konstatimet e Komisionit nga hetimi administrativ subjekti** shpreh bindjen se nëse nga DSIK-ja do të ishin analizuar të gjitha këto fakte në harmoni mes tyre, mendon se edhe Komisioni do ta kishte të mundur për të arritur në konkluzionin se, aftësia e subjektit për t'i rezistuar përballjes me presionin e korrupsionit është testuar në një masë dhe për një kohë të mjaftueshme dhe për këtë arsye do të kishte pranuar ta vlerësonte si person të përshtatshëm për të vazhduar të ushtrijë këtë profesion.

11. **Komisioni, pasi shqyrtoi dhe analizoi shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit arrin në përfundimin se,** subjekti i rivlerësimit ka plotësuar formularin e deklarimit të kontrollit të figurës në mënyrë të saktë dhe me vërtetësi dhe nga hetimi nuk kishte asnjë informacion në deklarimin e subjektit ose gjetkë që tregon se subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas kushteve të parashikuara në nenin 38 të ligjit nr. 84/2016.

12. Për sa i përket konstatimeve për përfshirjen në llotari sportive, këto veprime lidhen me etikën dhe angazhimin ndaj vlerave profesionale të prokurorit.

13. **Si konkluzion,** raporti i dërguar nga DSIK-ja nuk do të merret në konsideratë, si i pabazuar në prova dhe fakte.

VII. VLERËSIMI PROFESIONAL

1. **Raporti nga Grupi i Punës pranë zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm** ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt rivlerësimi, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe të 5 dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar⁹, në përputhje me nenin 43 të ligjit nr. 84/2016.

Analiza e gjetjeve sipas raportit të përgatitur nga Grupi i Punës pranë Prokurorisë së Përgjithshme për subjektin e rivlerësimit, është si më poshtë :

1.1 **Në lidhje me aftësitë profesionale,** ku përfshihen njohuritë ligjore dhe arsyetimi ligjor, nga vlerësimet e punës së subjektit të rivlerësimit, z. Artur Selmani, për vitet 2014, 2015 dhe 2016 të bëra nga Prokurori i Përgjithshëm, rezulton se ato janë shumë mirë.

1.2 **Në lidhje me aftësitë organizative,** ku përfshihen aftësia për të përballuar ngarkesën në punë, aftësia për të kryer procedurat hetimore dhe aftësia për të administruar dosjet, nga vlerësimet e punës së subjektit të rivlerësimit, z. Artur Selmani, për vitet 2014, 2015 dhe 2016 të bëra nga Prokurori i Përgjithshëm, rezulton se ato janë shumë mirë.

1.3 **Në lidhje me etikën dhe angazhimin ndaj vlerave profesionale,** ku përfshihen etika në punë, integriteti dhe paanësia, nga vlerësimet e punës së subjektit të rivlerësimit, z. Artur

⁹ Me shkresën nr. ***, datë 15.05.2018, hartuar nga Prokuroria e Përgjithshme.

Selmani, për vitet 2014, 2015 dhe 2016 të bëra nga Prokurori i Përgjithshëm, rezulton se ato janë shumë mirë.

1.4 **Në lidhje me aftësitë personale dhe angazhimi profesional**, ku përfshihen aftësitë komunikuese, aftësitë për të bashkëpunuar dhe gatishmëria për tu angazhuar, nga vlerësimet e punës së subjektit të rivlerësimit, z. Artur Selmani, për vitet 2014, 2015 dhe 2016 të bëra nga Prokurori i Përgjithshëm, rezulton se ato janë shumë mirë.

1.5 **Nga ankesat apo masat disiplinore nga të dhënat arkivore, rezultojnë se** subjekti i rivlerësimit, z. Artur Selmani, me urdhrin e Prokurorit të Përgjithshëm, nr. ***, datë 23.02.2017, është *pezulluar* nga detyra, pasi ndaj tij ishte regjistruar çështja penale nr. ***, datë 23.02.2017, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë. Me urdhrin nr. ***, datë 03.04.2017, të Prokurorit të Përgjithshëm është revokuar urdhri nr. ***, datë 23.02.2017, dhe është kthyer në detyrë.

1.6 **Ky raport është hartuar bazuar në përshkrimin dhe analizimin e :**

- i. Formularit të vetëdeklarimit, të tre dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga vetë subjekti i rivlerësimit, si dhe të dhënave dhe dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit dhe që janë paraqitur nga vetë subjekti i rivlerësimit;
- ii. Pesë dosjeve penale të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor;
- iii. Të dhënat nga burimet arkivore të Prokurorisë së Përgjithshme.

2. Informacione të marra nga burime të tjera sipas nenit 44 të ligjit nr. 84/2016 – pezullimi i subjekti të rivlerësimit nga detyra.

2.1 Referuar burimeve mediatike (të shkruara dhe vizuale), informacionit të marrë nga Prokuroria e Përgjithshme, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë si dhe Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda, relatori konstatoi se :

2.2 Më datë 21.02.2017, në media të ndryshme janë publikuar ankesa të familjarëve të viktimave që kanë mbetur të vrarë, më datë 07.04.2015, në lagjen “Çole”, Vlorë. Familjarët i janë drejtuar me letër të hapur institucioneve dhe Presidentit të Republikës, duke pretenduar se prokurorët e Prokurorisë së Përgjithshme, Artur Selmani dhe A. M., kanë mbajtur qëndrime të ndryshme nga prokurorët e Prokurorisë së Shkallës së Parë dhe të Apelit Vlorë, duke lehtësuar akuzat ndaj të pandehurve B. A., A. B., dhe A. Ll.

2.3 Më datë 23.02.2017, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, është regjistruar çështja penale nr. ***, për veprat penale të dyshuara të parashikuara nga nenet 248, 244 dhe 258 të Kodit Penal, në ngarkimin të subjektit të rivlerësimit. Çështja penale është regjistruar mbi bazën e informacionit të publikuar në media të ndryshme.

2.4 Po në të njëjtën datë 23.02.2017, Prokurori i Përgjithshëm, me urdhrin nr. ***, ka vendosur pezullimin e subjektit të rivlerësimit nga detyra deri në përfundim të hetimeve, të procedimit penal nr. ***, datë 23.02.2017, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës Parë Tiranë, sipas të dhënave arkivore të Vlerësimit Profesional të Prokurorisë së Përgjithshme.

2.5 Më datë 03.04.2017, Prokurori i Përgjithshëm ka revokuar urdhrin e pezullimit nga detyra, me urdhrin nr. ***, ku ka urdhëruar revokimin e urdhrin nr. ***, datë 23.02.2017.

2.6 Në të njëjtën ditë, më datë 03.04.2017, Prokurori i Përgjithshëm me anë të vendimit nr. ***, ka vendosur që ju të caktoheni përkohësisht në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër, nga data 04.04.2017 - 04.07.2017, bazuar në nenin 160, pika 4 dhe neni 59 të ligjit nr. 97/2016.

2.7 Në përfundim të hetimeve të kryera, prokurori i çështjes ka konkluduar se nuk ka rezultuar që subjekti si person nën hetim në funksionin e prokurorit, të jeni ndikuar në mënyrë të paligjshme, të keni premtuar apo të keni kërkuar apo pranuar përfitime të paligjshme në ushtrimin e detyrës si prokuror. Duke u bazuar në nenin 328/1, germat « b » dhe « dh » të Kodit të Procedurës Penale, me aktin e datës 31.05.2017, ka vendosur të pushojë hetimet e procedimit penal.

2.8 Më datë 03.07.2017, Prokurori i Përgjithshëm, me vendimin nr. ***, ka vendosur komandimin e subjektit të rivlerësimit përkohësisht në të njëjtën detyrë, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit për Krimet të Rënda.

2.9 Më datë 25.09.2017, me vendimin nr. ***, Prokurori i Përgjithshëm, ka vendosur ndërprerjen e komandimit dhe kthimin në pozicionin e mëparshëm atë të prokurorit të Prokurorisë së Përgjithshme.

2.10 Më datë 06.07.2017, është regjistrua kallëzimi penal me nr. *** prot., kundër subjektit të rivlerësimit etj., për veprën penale, korrupsion pasiv.

2.11 Në po të njëjtën datë Prokuroria e Përgjithshme ka marrë vendim për shpallje moskompetencë dhe kalimin e akteve të kallëzimit penal nr. ***, të viti 2017, Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet të Rënda Tiranë.

2.12 Më datë 10.10.2017, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet të Rënda Tiranë, regjistroi materialin kallëzues nr. ***, për veprat penale të dyshuara të parashikuara nga nenet 319/ç dhe 248 të Kodit Penal në ngarkimin të subjektit të rivlerësimit.

2.13 Kallëzimi penal është regjistruar mbi bazën e ankimit të shtetasve I. V., dhe B. R., të cilët kanë pretenduar se prokurorët e Prokurorisë së Përgjithshme, Artur Selmani dhe A. M., nuk kanë përkrahur qëndrimin e prokurorëve të Prokurorisë së Apelit Vlorë, në shqyrtimin e çështjes në Gjykatën e Lartë, me të pandehur A. Ll., etj por kanë kërkuar pushimin e akuzave të rënda ndaj tyre.

2.14 Prokurori i çështjes, me aktin e datës 25.10.2017, ka vendosur të mosfillojë procedimin penal me arsyetimin se fakti i kallëzuar nuk parashikohet nga ligji si vepër penale, bazuar në nenet 291 e 290/1, germa « ç » të Kodit të Procedurës Penale.

2.15 Më datë 19.10.2018, në lidhje me pezullimin, subjekti me anë të postës elektronike, e-mail deklaroi se: *“E vlerësoj të nxituar pezullimin tim nga detyra nga Prokurori i Përgjithshëm. Në bazë të legjislacionit në fuqi pezullimi nga detyra i prokurorit si akt procedural që nxirret nga Prokurori i Përgjithshëm nuk përbën në vetvete shkak të nisjes së një procedimi penal. Shkak për pezullimin janë vetëm marrja e një mase sigurimi ndaj prokurorit, gjë që nuk rezulton në rastin tim, si dhe komunikimi i një akuze penale ndaj prokurorit, gjë që edhe kjo nuk rezulton të ketë ndodhur në rastin tim. Thënë ndryshe Prokurori i Përgjithshëm nuk ka kompetencë as të urdhërojë nisjen e një procedimi penal dhe as të pezullojë një prokuror nga detyra, në kushtet kur ndaj tij prokuroria nuk ka nisur ende një procedim penal, nuk është komunikuar ende një akuzë apo nuk është caktuar ende ndonjë masë sigurimi personal.”*

2.16 Më datë 19.10.2018, në përgjigje të pyetësorit të dërguar Komisionit, subjekti deklaroi se : *“Për sa i përket mënyrës se si arrita të krijoj bindjen time të brendshme lidhur me qëndrimin që do të mbaja në seancë gjyqësore mund t’ju them se fillimisht për këtë çështje unë jam vënë në dijeni nga ndihmësja ime ligjore K. M., e cila, pas studimit të dosjes përkatëse*

gjqësore, më shprehu me informacion me shkrim sugjerimin e saj rreth qëndrimit që duhej mbajtur nga prokurori para Kolegjit Penal. Sipas këtij sugjerimi të shkruar të ndihmëses ligjore, akuzat e ngritura ndaj të pandehurve nuk ishin të mbështetura në prova. Sipas analizës që i bëra edhe vetë më pas materialeve të dosjes si edhe diskutimeve që pata me ndihmësen ligjore, edhe unë arrita në të njëjtin konkluzion. Gjithsesi për të mos lejuar mundësi gabimi në qëndrimin tim, unë mendova ta diskutoja rastin edhe me drejtoreshën e Drejtorisë Gjyqësore, znj. A. M. Paraprakisht i nisa me e-mail zyrtar edhe relacionin që kishte përgatitur ndihmësja ligjore K. M.. Nga relatimi me gojë që i bëra këtij rasti në takim si dhe nga diskutimi që patëm me drejtoreshën në prani edhe të ndihmëses ligjore, u arrit në përfundimin se provat nuk ishin të mjaftueshme për të mbështetur akuzat. Madje drejtore A. M., thotë subjekti, jo vetëm u shpreh në favor të këtij qëndrimi por madje më inkurajoi duke më thënë se në fund të fundit unë isha i pavarur në seancë gjyqësore dhe nuk kisha përse të druhesha ta shprehja mendimin tim ashtu siç e kisha. Në këto rrethana unë përgatita fjalën time para Gjykatës së Lartë në seancën e datës 14.02.2017, i bindur tashmë në drejtësinë e qëndrimit tim mbas dakordësimit të atij qëndrimi edhe me drejtore A. M.”.

2.17 Më datë 23.02.2017, znj. A. M., deklaroi para OPGJ-së, A. D., se: *“Ka pasur diskutime deri në debat me prokurorin Artur Selmani për bërjen e rekursit në Gjykatën e Lartë për rastin në fjalë. Znj. A. M., në deklaratën e saj citon se: Gjatë shpjegimeve (për qëndrimin para Gjykatës Lartë të subjektit), më shumë prokurori por i mbështetur dhe nga ndihmësja ligjore në ato që thoshte, pretendonin që rasti në fjalë nuk kishte provat e duhura për tu mbështetur rekursi i prokurorit në Gjykatën e Lartë që do zhvillohej të nesërmen në orën 10:00. Kemi diskutuar rreth 30 minuta dhe e kam pyetur prokurorin se përfundimisht çfarë t`i mendon që erdhe të diskutosh këtu me mua. Ai tha se mendoj se provat janë të zbehta dhe nuk mendoj se duhet mbështetur rekursi i prokurorit. Unë i them mbi çka diskutuam edhe pse rasti është ende i rëndë nisur dhe nga fakti që prokurori dhe Gjykata e Shkallës Parë dhe e Apelit ishin në një qëndrim duke dhënë fajësi dhe dënim maksimal ndaj të pandehurve, ne duhet të mbështesim rekursin e prokurorit. Në këtë moment prokurori filloj shpjegimet teorike duke thënë se si mund të dënohen njerëz të pafajshëm, ne jemi prokuror që kemi qëndrimin tonë, pse duhet të mbështesim rekursin, pra nga diskutim kaluam në “debat”. Prokurori këmbëngulte në qëndrimin e tij megjithëse unë jam munduar që të jepja argumente kundër qëndrimeve të tij teorike. Që nga ky moment janë larguar të dy dhe prokurori dhe ndihmësja dhe unë si drejtuese nuk e kam akoma me shkrim mendimin e këtij prokurori lidhur me rastin në fjalë. Në këto kushte përgjigjet e subjektit në pyetësor vijnë në kundërshtim me deklaratimet e drejtoreshës pranë Drejtorisë Gjyqësore në Prokurorinë e Përgjithshme, znj. A. M., para OPGJ-së, më datë 23.02.2017. Qëndrimi i subjektit në Gjykatën e Lartë nuk ka qenë siç deklaroi subjekti me “dakordësimin e atij qëndrimi edhe me drejtore A. M.”, por ato kanë debatuar para seancës deri në “debat” pasi A. M., nuk ka qenë dakord me mendimin e prokurorit për qëndrimin e tij para Kolegjit të Gjykatës së Lartë për çështjen penale në fjalë”.*

2.18 Nga hetimi i Komisionit u konstatua se neni 110 i ligjit nr. 96/2016, parashikon se masa e pezullimit jepet në rastet kur:

- ✓ Shkelja e kryer është shumë e rëndë, dhe
- ✓ Rëndësia e shkeljes dhe dëmi që i shkaktohet imazhit të prokurorit, kërkojnë që magjistrati të pezullohet për një kohë të caktuar, pavarësisht se natyra dhe rrethanat e

kryerjes së shkeljes nuk e bëjnë magjistratin të papërshtatshëm ose të padenjë për të ushtruar funksionin.

2.19 Ndërsa subjekti i rivlerësimit shprehet se shkak për pezullimin janë vetëm marrja e një mase sigurimi ndaj prokurorit, gjë që nuk rezulton në rastin e tij, si dhe komunikimi i një akuze penale ndaj prokurorit, gjë që edhe kjo nuk rezulton të ketë ndodhur në rastin e tij.

2.20 Duket sikur me anë të sjelljes dhe qëndrimit të mbajtur në Gjykatën e Lartë për çështjen penale me nr. *** Akti, me të pandehur A. Ll., A. B., B. A., akuzuar për: kryerjen e veprës penale “Vrasje në rrethana të tjera cilësuese” e kryer ndaj dy ose më shumë personave, të kryera në bashkëpunim “Prodhim dhe mbajtje pa leje e armëve dhe municioneve luftarake” në ambiente publike, subjekti i rivlerësimit nuk ka respektuar normalisht të drejtat e viktimave në këtë proces.

2.21 Subjekti i rivlerësimit në lidhje me këto konstatime, shpjegoi se sikurse del qartë në urdhrin nr. ***, datë 23.02.2017, të Prokurorit të Përgjithshëm për pezullimin e tij nga detyra, ky pezullim është kryer në bazë të nenit 160, pika 2, germa « c » i ligjit nr. 96/2016. Duke iu referuar përmbajtjes së këtij neni rezulton se ky lloj pezullimi përbën pezullim të detyruar i cili vendoset nga Prokurori i Përgjithshëm në rastet kur ndaj prokurorit nis një procedim penal apo caktohet një masë sigurimi, në kuadër të një procedimi penal të nisur ndaj tij. Pra qartazi, urdhri nr. ***, datë 23.02.2017, nuk përbën masë disiplinore. Nëse do të ishte masë disiplinore atëherë baza e tij ligjore do të kishte qenë jo neni 160, pika 2, germa « c », por neni 110, i ligjit nr. 96/2016.

2.22 Duke qenë se urdhri nr. ***, datë 23.02.2017, i Prokurorit të Përgjithshëm përbën një pezullim detyrues, parashikuar nga neni 160, pika 2, germa « c » i ligjit nr. 96/2016 edhe shkaqet për të cilat ai urdhër është marrë nuk mund të kërkohen në nenin 110 të ligjit nr. 96/2016. Kjo do të thotë se urdhri nr. ***, datë 23.02.2017, nuk është bazuar në përfundimin se unë kisha kryer shkelje të rëndë të ligjit, siç parashikon neni 110 i ligjit, por për shkak të nisjes ndaj meje të një procedimi penal, siç parashikon neni 160 i ligjit nr. 96/2017.

2.23 Konkluzionet e arritura në relacion në lidhje me aftësitë profesionale të subjektit të rivlerësimit nuk janë të bazuara në fakte dhe prova konkrete dhe aktet që përmban dosja hetimore e Komisionit vërteton të kundërtën e konkluzioneve të arritura në relacion, pikërisht për nivelin tim të kënaqshëm profesional, të shfaqur për një kohë relativisht të gjatë, nivel ky i përshtatshëm për të përfaqësuar prokurorinë në instancën më të lartë gjyqësore të përfaqësimit të akuzës, pikërisht pranë Gjykatës së Lartë dhe Gjykatës Kushtetuese.

2.24 Komisioni, pasi shqyrtoi dhe analizoi shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit arrin në përfundimin, se subjekti i rivlerësimit ka marrë masë disiplinore sipas nenit 110 dhe shkronjës b të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

2.25 Ky nen i sipërcituar parashikon se: *“Masa e pezullimit nga detyra e magjistratit, me të drejtë për të marrë pagën minimale për një periudhë nga 3 muaj në 2 vjet, jepen vetëm në këto raste... b) kur këshilli (në rastin tonë Prokurori i Përgjithshëm sipas dispozitës tranzitore) çmon se pavarësisht se natyra dhe rrethanat e kryerjes së shkeljes nuk e bëjnë magjistratin të papërshtatshëm ose të denjë për të ushtruar funksionin, rëndësia e shkeljes dhe dëmi që i është shkaktuar imazhit të prokurorit, kërkojnë që magjistrati të pezullohet për një kohë të caktuar.”*

2.26 Pra, po ti referohemi nenit të sipërcituar, përderisa subjekti ka marrë një masë pezullimi si masë disiplinore, qëndrimi i tij në lidhje me çështjen penale në fjalë konsiderohet si shkelje, rrethanat e së cilës nga aspekti profesional nuk e bëjnë subjektin e rivlerësimit të papërshtatshëm ose të padenjë për të ushtruar funksionin, por rëndësia e këtij veprimi/shkelje dhe dëmi që i është shkaktuar imazhit të prokurorit, kanë kërkuar që subjekti i rivlerësimit të pezullohet për një kohë të caktuar.

2.27 Nëse subjekti i rivlerësimit mendonte se urdhri i pezullimit nga ana e prokurorit ishte i paligjshëm, atëherë ai duhej të kishte investuar gjykatën për të kërkuar anulimin e urdhrin të prokurorit të përgjithshëm si të pabazuar në ligj dhe prova, gjë të cilën subjekti i rivlerësimit nuk e ka bërë.

2.28 Ky qëndrim i subjekti i ka shkaktuar dëm imazhit të prokurorit dhe për rrjedhojë ka ulur shkallën e besimit të publikut tek institucioni i prokurorisë.

2.29 **Pretendimit të subjekti të rivlerësimit, se urdhri nr. ***, datë 23.02.2017, i Prokurorit të Përgjithshëm për pezullimin e tij nga detyra, ky pezullim është kryer në bazë të nenit 160, pika 2, germa « c », i ligjit nr. 96/2016, nuk qëndron, pasi kjo referencë vetëm përcakton se :** *“Deri në krijimin e Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Prokurori i Përgjithshëm do të vazhdojë të ushtrojë kompetencat e mëposhtme : c) pezullon prokurorët, sipas procedurës dhe kritereve të parashikuara në ligj”*, pra kjo bazë ligjore është vetëm për të legjitimuar Prokurorin e Përgjithshëm se në bazë të ligjit të ri, ai mund të jepte këtë urdhrë.

2.30 Në lidhje me pezullimin, në ligjin nr. 96/2016, ai është parashikuar si masë disiplinore në nenin 110 “Pezullimi si masë disiplinore”, por dhe në nenin 152 “Pezullimi mbi bazë diskrecioni”. Nëse i analizojmë të dy këto nene, kanë një gjë të përbashkët si shkak për pezullimin, që është cenimi i imazhit të magjistratit.

2.31 Nëse do i referohemi nenit 110 të ligjit nr. 96/2016 si masë disiplinore, rezulton se shkelja ka qenë e rëndë saqë i ka shkaktuar dëm imazhit të prokurorit dhe prandaj është dhënë masa disiplinore e pezullimit.

2.32 Por dhe nëse i referoheni nenit 152 të ligjit nr. 96/2016, Prokurori i Përgjithshëm ka krijuar bindjen se ky qëndrim diskretiton rëndë figurën dhe imazhin e prokurorit dhe për këtë arsye ka pezulluar subjektin.

2.33 **Si konkluzion,** subjekti i rivlerësimit referuar dhe urdhrin të Prokurorit të Përgjithshëm, por dhe komentet në media të ndryshme të shkuara apo audiovizive të kohës, ka cenuar besimin e publikut tek sistemi i drejtësisë.

3 Informacione të marra nga burime të tjera sipas nenit 44 të ligjit nr. 84/2016 – përfshirja në llotari sportive të subjektit të rivlerësimit.

3.1 Në deklaratën e interesave privatë periodikë 2006, 2007 dhe 2008, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se ka fituar në llotari sportive shumën prej 10.000 USD, në total për të tre vitet.

3.2 Në deklaratën “Vetting” të vitit 2017, subjekti i rivlerësimit, deklaroi se ka gjendje *cash*, në shumën 950.000 lekë dhe depozitë bankare në shumën 2.500.000 lekë, pranë “Raiffeisen Bank”.

3.3 Në deklaratimet e tij në përgjigje të pyetësorit të drejtuar nga Komisioni, më datë 19.10.2018¹⁰, subjekti i rivlerësimit, deklaroi se këto shuma janë krijuar duke llogaritur të ardhurat nga llotari sportive, është si më poshtë:

- ✓ në vitin 2006 ka pasur shumën 489.591 lekë, duke përfshirë të ardhurat nga llotaria sportive në shumën 400.000 lekë;
- ✓ në vitin 2007 ka pasur shumën 1.368.966 lekë, duke përfshirë të ardhurat nga llotaria sportive në shumën 200.000 lekë;
- ✓ në vitin 2008 ka pasur shumën 2.279.582 lekë, duke përfshirë të ardhurat nga llotaria sportive në shumën 400.000 lekë;

3.4 Nga hetimi administrativ kryesisht për këtë informacion, u konstatua se përfshirja në llotari sportive, për nga vetë natyra e këtyre aktiviteteve në Shqipëri por jo vetëm, cenon figurën e një prokurori dhe pse nuk ishte e ndaluar me ligj, pasi të fitosh në llotari sportive duhet të marrësh parasysh elementin e varësisë dhe imazhin që lë ky aktivitet tek publiku.

3.5 Subjekti i rivlerësimit në lidhje me këto konstatime, shpjegoi se në lidhje me vlerësimin e integritetit tim në relacion përfshihet edhe fakti se ai ka deklaruar përgjatë 3 viteve se kam arritur të fitoj nga lojërat sportive një shumë të përgjithshme prej afërsisht 10.000 USD.

3.6 Më tej subjekti i rivlerësimit shpjegoi se: *“Lidhur me këtë gjetje në relacion më lejoni të pohoj përpara jush se sot nuk ndihem aspak krenar për atë periudhë 3-vjeçare tashmë të shkuar një herë e mirë prej më se 10 vitesh. Dua të pohoj, po kështu, para jush se e vërteta është se në atë kohë përfshirja në lojëra sportive nuk më është dukur si diçka jo etike aq më pak e ndaluar ligjrisht. Madje edhe ndarja prej saj fillimisht nuk ndodhi si rezultat i ndërhyrjes së ndonjë faktori të brendshëm apo të jashtëm që më vuri në dukje se po bëja diçka të gabuar apo të ndaluar. Reflektimi im i vërtetë ndaj papërshtatshmërisë etike të përfshirjes në atë lojë ndodhi vetëm kohët e fundit, pikërisht pas nisjes së procesit të rivlerësimit kalimtar. Nga ky moment e në vazhdim jam ndjerë vërtet keq. Edhe pse nuk kisha dhe nuk kam asnjë dyshim rreth integritetit tim moral dhe profesional, përsëri nuk mund të mos u jepja të drejtë atyre zërave kritik të publikut. Vura re se sa lehtësisht mund të thyhej e cenohej besimi i publikut ndaj meje si prokuror madje edhe në kushtet kur më parë ky besim ishte shfaqur si i palëkundshëm. Për shkak të këtij reflektimi, unë sot para jush nuk dëshiroj t’ju paraqes ndonjë justifikim për veten për atë që kam kryer në ato 3 vite të para 10 viteve. Nuk dëshiroj të përdor si argument mbrojtës se loja sportive ishte dhe vazhdon të jetë në fund të fundit një veprimtari e ligjshme që i lejohet çdo qytetari të thjeshtë. Për hir të paraqitjes së një argumenti mbrojtës, nëse vërtet mund të quhet i tillë, mund t’ju them vetëm se kjo ka ndodhur për shkak të ndërgjegjësimit jo në shkallën e kërkuar që duket se paskam pasur në atë kohë në lidhje efektet e kësaj sjelljeje. Kjo duket se ka ndodhur edhe për shkak se kam lundruar në të njëjtin mjedis jo etik i cili ma ka ulur vigjilencën e vetëdijes aq sa e kam konsideruar sjelljen time si diçka normale të pranuar gjerësisht nga të gjithë. Por pavarësisht nga këto argumente mbrojtjeje, nëse do të cilësoheshin të tilla, unë sot nuk ndihem në paqe me veten time për këtë pakujdesi që kam shfaqur në atë kohë. Ndërkohë konstatoj me të njëjtën keqardhje mungesën e një reagimi dhe përpjekje nga ligjvënësi apo komuniteti i prokurorëve për të parashikuar barriera konkrete ligjore apo të karakterit etik, të cilat do të parandalonin që pjesëmarrja në lojërat*

¹⁰ E-maili më datë 19.11.2018

sportive të ushqente tek publiku hamendje apo dyshime rreth integritetit të figurës sonë. Kjo mangësi bën që ende edhe sot çdo prokuror të jetë i rrezikuar njësoj nga këto paragjykitime. Sot ende nuk ka një praktikë të konsoliduar, si duhet të veprojë një punonjës i drejtësisë në situata që përmbajnë dilema etike si p.sh., në rastin e dhuratave cash apo në natyrë, mënyrën e kufizimit të kontakteve me persona të panjohur etj., situata këto që hasen shpesh dhe në mënyrë të paevitueshme në jetën tonë të përditshme. Edhe vetë hierarkia e shkeljeve etike nuk është e qartë. Nuk është e qartë p.sh., kush përbën shkelje etike më të rëndë, rasti i konstatimit të pjesëmarrjes në një lojë sportive në të shkuarën, edhe pse nuk ka qenë e ndaluar ligjërisht dhe etikisht në atë kohë, apo rasti i një ndërtimi të paligjshëm të kryer nga prokurori, i cili edhe pse është legalizuar, ligji aktual e konsideron ende ndërtimin pa leje si një sjellje të paligjshme. Ky mosreagim ndaj kësaj situatë jo të qartë ligjore dhe etike nga Parlamenti, inspektori i etikës pranë Prokurorisë së Përgjithshme, ILDKPI-së, apo organe të tjera shtetërore, përbën shkakun e vërtetë përse janë konstatuar në të shkuarën raste të tilla. Ato sot stigmatizohen me të drejtë nga publiku si sjellje joetike. Por në kushtet e kësaj situatë të paqartë ligjore dhe etike ky stigmatizim rrezikon të çojë jo në ndalimin e kësaj sjelljeje por në zhvillim procesesh jo të rregullta të shqyrtimit të saj, sidomos në kushtet kur konstatimi ndodh pas kalimit të një periudhe kohore relativisht të gjatë madje në kohën kur subjekti nuk i shfaq më atë sjellje prej vitesh.

3.7 Megjithatë edhe pse e fajësoj veten për këtë sjellje, nga ana tjetër unë jam dhe nuk mund të mos ndihem krenar për integritetin tim profesional të cilin e kam treguar në mënyrë të vazhdueshme në kryerjen e detyrës së prokurorit, duke mos marrë parasysh në asnjë rast shkallën e dëmit personal nga mos bërja kompromis. Këtë fakt mund ta kishte konstatuar edhe vetë DSIK-ja nëse do të kishte analizuar se gjatë gjithë karrierës sime nuk kam pasur pothuajse asnjë rast që palët në proces të kenë shfaqur pretendime ndaj korrektësisë sime në detyrë. Edhe rasti i fundit i iniciuar nga Prokurori i Përgjithshëm rezultoi qartazi se asnjë person nuk arriti të demonstrojë një veprim konkret të kryer nga unë në kundërshtim me detyrën. Po kështu këtë integritet profesional të treguar në vite DSIK-ja mund ta kishte konstatuar edhe duke u bazuar tek mungesa e informacioneve për kontakte apo shoqëri të papërshtatshme me element me precedent kriminal apo të njohur si njerëz të botës së krimit. Këtë mund ta kishte konstatuar DSIK-ja edhe me anë të verifikimit të opinionit që ekziston rreth integritetit tim profesional mes kolegëve me të cilët kam punuar e punoj ose mes drejtuesve me të cilët kam bashkëpunuar në vite. Po kështu integriteti im mund të verifikohet edhe nga përfaqësimi i akuzës në disa procedime penale të njohura ku integriteti im është vënë në provë përballë presionit fizik dhe atij politik. Përmes këtyre përfaqësimeve të akuzës mund të konstatoheshin dy aspekte të rëndësishme të integritetit tim si prokuror.”

3.8 Komisioni, pasi shqyrtoi dhe analizoi shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit arrin në përfundimin, se pavarësisht nëse llotaritet sportive janë një aktivitet i lejuar ligjërisht, nga aspekti etik dhe atë social-kulturor në Shqipëri, personat që luajnë në llotari sportive konsiderohen si “persona me ves të keq”.

3.9 E parë në këtë këndvështrim por dhe bazuar në vlerësimin e etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale, të një prokurori (sipas nenit 75 të ligjit nr. 96/2016) dhe vlerat themelore se sjelljet e prokurorit gjatë ushtrimit të funksionit dhe jashtë tij duhet të garantojnë ruajtjen dhe forcimin e besimit të publikut tek sistemi i drejtësisë.

3.10 Komisioni arrin në konkluzionin se këto lloj sjelljesh të subjektit të rivlerësimit kanë cenuar, figurën dhe integritetin e tij, si dhe kanë ulur shkallën e besueshmërisë nga publiku tek sistemi i drejtësisë. Kjo vërtetohet dhe me komentet e shumta që ka pasur për subjektin e rivlerësimit gjatë kohës që ishte kandidatë për Prokuror të Përgjithshëm të përkohshëm në lidhje me përfshirjen në llotari sportive.

VIII. VLERËSIMI TËRËSOR I ÇËSHTJES

Në vlerësimin tërësor të çështjes, mbështetur në provat, faktet dhe rrethanat që Komisioni disponon për kriterin e vlerësimit e pasurisë, kontrollin e figurës, fakte të njohura botërisht si dhe vlerësimin profesional të kryer nga organi ndihmës i Prokurorisë së Përgjithshme si dhe vlerësimin tërësor të procedurave, Komisioni, arrin në përfundimin se:

a. Për Vlerësimin e Pasurisë, Komisioni, arrin në konkluzionin se:

1. **Për apartament banimi, me sipërfaqe 119 m², ndodhur në, Rr. “***”, Tiranë,** subjekti i rivlerësimit:

- i. arriti të shpjegojë bindshëm të kundërtën e faktit të konstatuar se ka mospërputhje në deklarin e sipërfaqes së apartamentit;
- ii. arriti të shpjegojë bindshëm se shuma prej 4.000.000 lekësh i ishte kaluar shitësve dhe pse pa një dokument ligjor provues;
- iii. kishte burime financiare të ligjshme për blerjen e këtij aseti me anë të huas.

2. **Për depozitën bankare pranë “Raiffeisen Bank”, në shumën prej 2.500.000 lekësh dhe gjendjen cash në shumë prej 950.000 lekësh,** subjekti i rivlerësimit:

- i. nuk shpjegoi bindshëm burimin e ligjshëm të të ardhurave nga dhuratat e bëra nga motra e subjektit, znj. T.S. dhe nëna e subjektit, znj. D.S.
3. **Ka mungesë të burimeve të ligjshme financiare me dokumentacion justifikues për dhuratat në vlerën 13.950 euro .**
 - i. ka deklarim të rremë në lidhje me qëllimin e këtyre dhurimeve, çka krijon dyshime nëse këto dhurata janë bërë apo jo.

4. **Për transfertat të kryera nga subjekti apo personat e lidhur me të, nëpërmjet Unionit Financiar të Tiranës,** subjekti i rivlerësimit:

- i. ka mungesë të dokumentacionit ligjor justifikues për të provuar se motra e subjektit, znj. T.S., ka pasur të ardhura nga burime të ligjshme për të bërë dhuratën prej 950.50 eurosh; dhe
- ii. subjekti i rivlerësimit shpjegoi bindshëm dhe provoi se persona me të njëjtin emër dhe mbiemër me të dhe bashkëshorten e tij, kishin kryer transaksione me Unionin Financiar “AK Invest”, por që nuk ishin të njëjtët persona me subjektin dhe bashkëshorten e tij, vërtetuar kjo me kartën e identitetit dhe letrën e dërguar nga “AK Invest”.

5. **Mungesa e dokumentacionit për të ardhurat nga angazhimi në përgatitjen e revistës “***”, projekt i qendrës L.I.S.T. Shuma 954 167 lekë.** Subjekti i rivlerësimit arriti të provojë me dokumentacion justifikues ligjor të ardhurat në shumën prej 954.167 lekësh, të fituara nga angazhimi në përgatitjen e revistës “***”, projekt i qendrës L.I.S.T.

6. **Për mungesën e dokumentacionit justifikues ligjor dalë nga analiza financiare për periudhë 2003 - 2016, subjekti i rivlerësimit** ka mungesë totale të të ardhurave nga burime të ligjshme në shumën prej – **3.533.901** lekësh.

b. Për Kontrollin e Figurës, Komisioni, arrin në konkluzionin se:

- i. Subjekti i rivlerësimit ka plotësuar formularin e deklarimit të kontrollit të figurës në mënyrë të saktë dhe me vërtetësi.
- ii. Nuk kishte asnjë informacion në deklarimin e subjektit ose gjetkë që tregon se subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas kushteve të parashikuara në nenin 38 të ligjit nr. 84/2016.
- iii. Raporti i dërguar nga DSIK-ja nuk do të merret në konsideratë nga Komisioni, si i pabazuar në prova dhe fakte, por vetëm në një vlerësim të përgjithshëm i cili është shumë subjektiv nga ana e DSIK-së.

c. Për Vlerësimin Profesional, Komisioni, arrin në përfundimin se:

7. Mbështetur në informacione të marra nga burime të tjera si dhe kriteret e vlerësimit të parashikuara në ligjin për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve si dhe në këndvështrimin e **përgjithshëm** të etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale, të një prokurori, dhe vlerat themelore se sjelljet e prokurorit gjatë ushtrimit të funksionit dhe jashtë tij duhet të garantojnë ruajtjen dhe forcimin e besimit të publikut tek sistemi i drejtësisë.

8. Me faktin e pranuar dhe nga vetë subjekti i rivlerësimit se ai ka qenë i përfshirë për 3 vite rresht në llotari sportive, ku ka fituar rreth 10.000 USD, dhe faktin që këto llotari sportive krijojnë varësi, pasi jo gjithmonë fiton por dhe humb, këto lloj sjelljesh apo përfshirjesh të subjektit të rivlerësimit kanë cenuar, figurën dhe integritetin e tij, si dhe kanë ulur shkallën e besueshmërisë nga publiku.

d. Për vlerësimin tërësor në lidhje me kriterin e pasurisë dhe atë profesional, Komisioni, arrin në përfundimin se:

9. Subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e pasurisë sipas parashikimeve të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, pasi nuk arriti të justifikojë me dokumentacion ligjor provues (i) për të ardhurat nga llotaritë sportive në shumën 10.000USD, (ii) për dhuratat nga personi tjetër i lidhur, motra e subjektit të rivlerësimit, znj. T.S. dhe (iii) për mungesën financiare totale për periudhën 2003 - 2016, në shumën – **3.533.901** lekësh.

10. Subjekti i rivlerësimit referuar urdhrin të Prokurorit të Përgjithshëm, faktit që subjekti i rivlerësimit nuk ka kërkuar në gjykatë anulimin e urdhrin të pezullimit , si dhe komenteve në media të ndryshme të shkuara apo audiovizive të kohës, me anë të qëndrimit të tij për çështjen në fjalë, ka cenuar besimin e publikut tek institucioni i prokurorisë.

11. Subjekti i rivlerësimit me anë të veprimeve dhe mosveprimeve të tij në lidhje me vlerësimin e pasurisë, dhe vlerësimin e përgjithshëm të etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale ka cenuar besimin e publikut tek sistemi i drejtësisë dhe ndodhet në kushtet e pamundësisë për plotësimin e mangësive nëpërmjet programit të trajnimit.

Në këto kushte, Komisioni, bazuar në provat që disponon, vlerësimin e çështjes në tërësi si dhe bindjen e brendshme vendosi që subjektin të rivlerësimit, z. Artur Selmani, prokuror pranë Prokurorisë së Përgjithshme, t'i jepet masa disiplinore e shkarkimit nga detyra.

PËR KËTO ARSYE,

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe neni D, DH, Ç, E dhe Ë të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë të ndryshuar si dhe nenit 61, pika 3 dhe 5 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Artur Selmani, prokuror pranë Prokurorisë së Përgjithshme
2. Vendimi i arsyetuar me shkrim u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, 30 ditë pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim ankimohet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisionerit Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
4. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në Tiranë, më datë 26.11.2018.

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Roland ILIA
Kryesues

Firdes SHULI
Anëtare

Etleda ÇIFTJA
Relatore

Sekretare gjyqësore
Olsida Goxhaj